FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.108 16 tetor 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9605 datë 11.9.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, malore"……	4235
Ligj nr.9606 datë 11.9.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2004 "Programi i sektorit të energjisë", me një grant prej 9 000 000 eurosh"…….	4252
Ligj nr.9607 datë 11.9.2006	Për Këshillin Konsultativ të Biznesit……	4254
Ligj nr.9608 datë 18.9.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë për afatet dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit për zhvillim"……	4256
Ligj nr.9609 datë 18.9.2006	Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar……	4261
Ligj nr.9610 datë 18.9.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit për shërbimin	4261

ajror”……..

Vendim i Kuvendit nr.60, datë 27.9.2006	Për mosmiratimin e objektit të kërkesës së 35 deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar “Për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin Sali Berisha, familjarët dhe të afërmit e tij”.	4271
Vendim i Kuvendit nr.61, datë 27.9.2006	Për emërimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare…….	4272
Udhëzim i KQZ nr.5, datë 4.10.2006	Për rregullat që duhen respektuar për afishimin e materialeve propagandistike në fushatë zgjedhore……	4273

LIGJ
Nr.9605, datë 11.9.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR (IFAD) PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË ZONAVE RURALE, MALORE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, malore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5055, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
E PROGRAMIT TË HUASË

Marrëveshje e Programit të Huasë e datës _____, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (këtej e tutje i quajtur Huamarrësi) dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (këtej e tutje i quajtur Fondi),

Duke qenë se:

A) Huamarrësi ka kërkuar një hua nga Fondi për financimin e realizimit të Programit të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Zonave Rurale Malore, të përshkruar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje (Programi);

B) Zhvillimi i programit rajonal; zhvillimi i sektorit privat; dhe programi i komponentëve të metodave të testimit të investimit dhe zbatimit në terren do të kryhet nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore të Huamarrësit (Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore) dhe për këtë qëllim, Huamarrësi do të vërë në dispozicion të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore një pjesë të të ardhurave të Huasë, të parashikuara në të sipas kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje;

C) Transformimi dhe zgjerimi i komponentit të fondit financiar për zonat malore të programit do të kryhet nga Fondi Financiar i Zonave Malore (Fondi Financiar për Zonat Malore) dhe për këtë qëllim, Huamarrësi do t'i mundësojë Fondit Financiar për Zonat Malore një pjesë të të ardhurave të Huasë, të parashikuara në të sipas kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje;

D) Huamarrësi synon të përftojë nga bashkëfinancuesit financim në sasinë e përafërt prej katër milionë e pesëqind e trembëdhjetë mijë dollarësh amerikanë (USD 4 513 000) për të asistuar në financimin e Programit (Bashkëfinancuesit) mbi kushtet që do të parashtrohen në marrëveshjet

midis Huamarrësit dhe bashkëfinancuesve (Marrëveshjet e bashkëfinancuesve);

E) Huaja do të administrohet nga institucioni bashkëpunues që do të caktohet nga Fondi; dhe

meqenëse në bazë të sa më sipër, si dhe të konsideratave të tjera, Fondi ka rënë dakord të mundësojë Huanë për Huamarrësin subjekt i termave dhe kushteve të paraqitura, referuar apo në përputhje me këtë Marrëveshje;

për sa më sipër, palët janë marrë vesh për sa më poshtë:

Neni 1
Dispozita të përgjithshme

SEKSIONI 1.01. Kushtet e përgjithshme. Kushtet e përgjithshme të Fondit për Financimin e Zhvillimit Bujqësor të datës 2 dhjetor 1998 (Kushtet e përgjithshme) i janë bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha dispozitat në të (të përmendura ose jo në mënyrë të qartë aty) përbëjnë një pjesë integrale të saj. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e papajtueshme me një dispozitë të kushteve të përgjithshme, dispozita e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojë, por asnjë dispozitë e saj nuk do të kufizojë përgjithshmërinë e asnjë dispozite të kushteve të përgjithshme.

SEKSIONI 1.02. Përkufizimet (a) Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, në qoftë se nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, termat e përcaktuara në kushtet e përgjithshme dhe në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje do të kenë kuptimet e përcaktuara këtu.

b) Termat që përdoren në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"AWPB" do të thotë çdo plan pune dhe buxheti vjetor për kryerjen e Programit gjatë një viti të veçantë të Programit, siç përshkruhet në seksionin 3.02.

"ALL" ose "lekë" do të thotë njësia monetare e Huamarrësit.

"Institucion bashkëpunues" do të thotë institucionet e përcaktuara si të tilla në seksionin 1.05.

"Viti fiskal" do të thotë viti fiskal i Huamarrësit, që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

"Agjencitë kryesuese të Programit" do të thotë Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi Financiar për Zonat Malore.

"Data e mbylljes së huasë" do të thotë data gjashtë muaj pas datës së përfundimit të Programit, ose një datë tjetër e mëvonshme që mund të përcaktohet nga Fondi dhe për të cilën Huamarrësi vihet në dijeni.

"Monedha e pagesës së shërbimit të Huasë" do të thotë monedha e përcaktuar si e tillë në seksionin 2.08 të kësaj Marrëveshjeje.

"MADA" do të thotë Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore.

"Komponentët e lidhur me MADA" do të thotë zhvillimi i programit rajonal; zhvillimi i sektorit privat; dhe programi i komponentëve të metodave të testimit të investimit dhe zbatimit në terren.

"MADP" do të thotë programi i zhvillimit të zonave malore.

"MAFF" do të thotë Fondi Financiar për Zonat Malore.

"Komponenti i lidhur me MAFF" do të thotë transformimi dhe zgjerimi i komponentit të Fondit Financiar për Zonat Malore të programit.

"Marrëveshja Financiare Subsidare me MAFF" do të thotë Marrëveshja ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit Financiar për Zonat Malore në lidhje me zbatimin e Programit të përshkruar në paragrafin 4 të shtojcës 3, e cila mund të ndryshohet ose amendohet herë pas here sipas nevojës me miratimin paraprak të Fondit.

"Data e mbylljes së Programit" do të thotë përvjetori i pestë i datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, ose një datë tjetër e mëvonshme që mund të përcaktohet nga Fondi dhe për të cilën Huamarrësi vihet në dijeni.

"Rreth i Programit" do të thotë rrethet e Bulqizës, Devollit, Dibrës, Gjirokastrës, Gramshit, Hasit, Kolonjës, Korçës, Kukësit, Librazhdit, Përmetit, Pogradecit, Pukës, Malësisë së

Madhe, Matit, Mirëditës, Shkodrës, Skraparit, Tepelenës, Tropojës dhe Vlorës, si dhe çdo distrikt tjetër në territorin e Huamarrësit, siç mund bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

"PIM" do të thotë manualet e zbatimit të Programit të përshkruar në pjesën B të shtojcës 3.

"Palë në Program" përfshin (por nuk kufizohet tek) secilën nga agjencitë kryesuese të Programit dhe agjencitë e siguruesit publikë dhe privatë të shërbimeve të kontraktuar për qëllime të zbatimit të Programit.

"Vit i Programit" do të thotë: (i) periudhën që fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe mbaron në 31 dhjetor; dhe (ii) çdo periudhë të mëpasshme që fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor ose për vitin e fundit që mbaron në datën e përfundimit të Programit.

"USD"ose "dollarë" do të thotë dollarë të Shteteve të Bashkuara, njësia monetare e SHBA-së.

SEKSIONI 1.03. Referencat dhe titujt. Në qoftë se nuk tregohet ndryshe, referencat në këtë Marrëveshje ndaj neneve, seksioneve dhe planeve i referohen neneve, seksioneve ose planeve të kësaj Marrëveshjeje. Titujt përshkrues të neneve të tilla, seksioneve ose planeve jepen vetëm për lehtësi reference dhe nuk formojnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

SEKSIONI 1.04. Detyrimet e Huamarrësit. Huamarrësi do të jetë plotësisht i përgjegjshëm te Fondi për ecurinë e duhur dhe në kohë të të gjitha detyrimeve që i caktohen atij sipas kësaj Marrëveshjeje. Në masën kur ndonjë subjekt/individ i përfshirë në zbatimin e Programit gëzon personalitetin ligjor veçmas nga Huamarrësi çdo reference për një detyrim të një subjekti/individi të tillë në këtë Marrëveshje do të konsiderohet një detyrim i Huamarrësit për të siguruar që një subjekt ose individ kryen një detyrim të tillë. Pranimi nga ndonjë subjekt ose individ të ndonjë detyrimi që i caktohet në këtë Marrëveshje, nuk do të prekë përgjegjësitë dhe detyrimet e mëposhtme të Huamarrësit.

SEKSIONI 1.05. Caktimi i institucionit bashkëpunues. Fondi synon të caktojë UNOPS, zyrën e OKB-së për shërbimet e projekteve si institucionin bashkëpunues, me përgjegjësitë e caktuara në nenin 3 të kushteve të përgjithshme, me qëllim administrimin e Huasë dhe mbikëqyrjen e Programit në përputhje me Marrëveshjen e bashkëpunimit. Huamarrësi bie dakord këtu me këtë caktim.

Neni 2
Huaja

SEKSIONI 2.01 Huaja. Duke iu nënshtruar termave dhe kushteve që janë përcaktuar më poshtë, Fondi bie dakord t'i japë Huamarrësit një hua për një shumë ekuivalente me pesë milionë e pesëqind mijë të drejta për tërheqje speciale (5500000 SDR) për qëllime të financimit të Programit.

SEKSIONI 2.02. Llogaria e Huasë dhe tërheqjet. Fondi do të hapë një llogari huaje në emër të Huamarrësit ku do të kreditojë sasinë e Huasë në vazhdim. Huamarrësi mund të kërkojë tërheqjen e parave nga llogaria e Huasë herë pas here duke filluar nga data e hyrjes në fuqi deri në datën e mbylljes së Huasë në valuta të ndryshme në lidhje me shpenzimet e pranueshme dhe në përputhje me planin 2 dhe (alokimi dhe tërheqja e të ardhurave të Huasë) dhe nenin IV (Llogaria e Huasë dhe tërheqjet) dhe seksionin 6.02 (Valutat për tërheqje) të kushteve të përgjithshme.

SEKSIONI 2.03 Llogaria e posaçme A. (a) Menjëherë pas kësaj, por jo më vonë se nëntëdhjetë (30) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të hapë dhe mbajë një llogari programi të emëruar llogaria e posaçme A në dollarë amerikanë në Bankën e Shqipërisë ose në një bankë tjetër të propozuar nga Huamarrësi dhe të pranuar nga Fondi. Llogaria e posaçme A do të përdoret për aktivitetet e programit të financuara nga Huaja dhe që do të zbatohen nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA). Llogaria e posaçme A duhet të mbrohet nga konfiskimi, sekuestrimi apo përvetësimi në përputhje me termat dhe kushtet e propozuara nga Huamarrësi dhe të pranueshme nga Fondi.

b) Pasi të jetë hapur në mënyrën e duhur, llogaria e posaçme A, me kërkesë të Huamarrësit, Fondi do të bëjë një tërheqje prej tetëqind mijë dollarë 800.000 USD (alokimi i autorizuar) nga llogaria e Huasë në emër të Huamarrësit dhe do ta depozitojë këtë sasi në llogarinë e posaçme A. Herë pas here dhe me kërkesë të Huamarrësit, Fondi do të derdhë në llogarinë e posaçme A, në përputhje me seksionin 4.08 (llogaria e posaçme) të kushteve të përgjithshme në sasi të tilla

minimale që Fondi, apo institucioni bashkëpunues në emër dhe për llogari të Fondit, mund të përcaktojë duke e vënë në dijeni për këtë Huamarrësin.

c) Huamarrësi do të jetë plotësisht i autorizuar të operojë llogarinë e posaçme A në përputhje me seksionin 4.08 (llogaria e posaçme) të kushteve të përgjithshme.

SEKSIONI 2.04 Llogaria e posaçme B. (a) Menjëherë pas kësaj, por jo më vonë se nëntëdhjetë (30) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të hapë dhe mbajë një tjetër llogari programi të emëruar llogaria e posaçme B në dollarë amerikanë në Bankën e Shqipërisë ose në një bankë tjetër të propozuar nga Huamarrësi dhe të pranuar nga Fondi. Llogaria e posaçme B do të përdoret për aktivitetet e programit të financuara nga Huaja dhe që do të zbatohen nga Fondi i Financimit të Zonave Malore (MAFF). Llogaria e posaçme B duhet të mbrohet nga konfiskimi, sekuestrimi apo përvetësimi në përputhje me termat dhe kushtet e propozuara nga Huamarrësi dhe të pranueshme nga Fondi.

b) Pasi të jetë hapur në mënyrën e duhur, llogaria e posaçme B, me kërkesë të Huamarrësit, Fondi do të bëjë një tërheqje prej tetëqind mijë dollarë 800.000 USD (alokimi i autorizuar) nga llogaria e Huasë në emër të Huamarrësit dhe do ta depozitojë këtë sasi në llogarinë e posaçme B. Herë pas here dhe me kërkesë të Huamarrësit, Fondi do të derdhë në llogarinë e posaçme B në përputhje me seksionin 4.08 (llogaria e posaçme) të kushteve të përgjithshme në sasi të tilla minimale që Fondi apo institucioni bashkëpunues, në emër dhe për llogari të Fondit, mund të përcaktojë duke e vënë në dijeni për këtë Huamarrësin.

c) Huamarrësi do të jetë plotësisht i autorizuar të operojë llogarinë e posaçme B në përputhje me seksionin 4.08 (llogaria e posaçme) të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 2.5 Përdorimi i të ardhurave. Huamarrësi do të përdorë të ardhurat e Huasë ekskluzivisht për të financuar Programin në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me kushtet e përgjithshme. Pa kufizuar vazhdimësinë, është rënë dakord dhe mirëkuptuar se në bazë të politikave të Fondit të ardhurat e Huasë nuk do të përdoren për pagimin e asnjë takse importimi për prokurimin apo për furnizimin e një malli, punimi apo shërbimi të financuar nga Huaja.

Seksioni 2.06. Tarifa e shërbimit. Huamarrësi do t'i paguajë Fondit një tarifë shërbimi në koeficientin tre të katërtat e 1% (3/4 e 1%) në vit mbi shumën principale të Huasë të tërhequr dhe të mbetur herë pas here, të pagueshëm dy herë në vit, çdo 1 qershor dhe 1 dhjetor në monedhën e pagesës së shërbimit të Huasë.

Seksioni 2.07. Ripagesa e shumës principale. Huamarrësi do të ripaguajë shumën principale të Huasë së tërhequr dhe të mbetur herë pas here në pesëdhjetë e nëntë këste të barabarta gjashtëmujore prej 91,667 të drejta për tërheqje speciale (SDR) të pagueshme çdo 1 qershor dhe 1 dhjetor duke filluar më datë 1 qershor 2016 dhe duke përfunduar në datë 1 qershor 2045, si dhe këstin e fundit prej 91,647 të drejta për tërheqje speciale (SDR) të pagueshme më 1 dhjetor 2045 në monedhën e pagesës së shërbimit të Huasë.

Seksioni 2.08. Monedha e pagesës së shërbimit të Huasë. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është zgjedhur si monedha e pagesës së shërbimit të Huasë për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Programi

SEKSIONI 3.01. Zbatimi i Programit. Huamarrësi deklaron përkushtimin e tij për arritjen e objektivave dhe qëllimeve të Programit të parashtruara në planin 1 dhe, për realizimin e mëtejshëm të këtyre objektivave dhe qëllimeve, Huamarrësi do të sigurojë që agjencitë kryesore të programit dhe secili prej palëve në Program do të realizojë programin:

a) me përkushtim dhe efikasitet;

b) në përputhje me të gjitha praktikat e duhura administrative, inxhinierike, financiare, ekonomike, operative, mjedisore, të zhvillimit bujqësor (duke përfshirë praktikat e zhvillimit rural), si dhe të qeverisjes së mirë;

c) në përputhje me planet, standardet e projektimit, specifikimet, prokurimin dhe afatet kohore të punës dhe metodat e ndërtimit të rëna dakord nga Huamarrësi dhe institucioni bashkëpunues;

d) thellësisht në përputhje me planin e punës dhe buxhetin vjetor;

e) në përputhje me këtë Marrëveshje (në mënyrë të posaçme me shtojcat 3 dhe 4A këtu), si dhe me çdo dokument tjetër të Huasë;

f) në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e arritjeve të Projektit me kalimin e kohës.

SEKSIONI 3.02. Planet e punës dhe buxhetet vjetore. a) Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të konsolidojë dhe përgatisë draftin e planit dhe buxhetit vjetor të punës për çdo vit programi. Drafti i planit vjetor të punës dhe buxheti do të përfshijë, midis të tjerash, një plan prokurimi, një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të planifikuara të Programit gjatë vitit të ardhshëm të Programit, duke përfshirë outputet e pritshme dhe indikatorët operacionalë dhe burimet e përdorimet e fondeve, bazuar në planet përkatëse të punës dhe buxhetit të përgatitura nga secila prej palëve të Programit.

b) Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do t'i dorëzojë Fondit dhe institucionit bashkëpunues draftin e planit vjetor të punës dhe buxhetin, për komentet e tyre në lidhje me të dhe për miratim, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para fillimit të vitit përkatës të Programit. Nëse as Fondi, as institucioni bashkëpunues nuk bëjnë komente në lidhje me draftin e planit vjetor të punës dhe buxhetin brenda 30 ditësh pas marrjes së tij, drafti i planit vjetor të punës dhe buxheti do të konsiderohen të miratuar.

c) Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të adoptojë draftin e planit të punës dhe buxhetin vjetor kryesisht në formën e pranuar nga Fondi dhe institucioni bashkëpunues dhe Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të sigurojë kopje të tij për Fondin dhe institucionin bashkëpunues, para fillimit të vitit përkatës të Programit.

d) Nëse kërkohet, Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore mund të propozojë rregullime në draftin e planit vjetor të punës dhe buxhetin gjatë vitit përkatës të Programit, të cilat do të bëhen efektive me miratimin nga Fondi dhe institucioni bashkëpunues.

e) Fondi Financiar për Zonat Malore do të konsolidojë dhe përgatisë draftin e planit vjetor të punës dhe buxhetin për çdo vit programi. Drafti i planit vjetor të punës dhe buxhetit do të përfshijë midis të tjerash, një plan prokurimi, një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të planifikuara të Programit gjatë vitit të ardhshëm të Programit, duke përfshirë outputet e pritshme dhe indikatorët operacionale dhe burimet e përdorimet e fondeve, bazuar në planet përkatëse të punës dhe buxhetet të përgatitura nga secila prej palëve të Programit.

f) Fondi Financiar për Zonat Malore do t'i dorëzojë Fondit dhe institucionit bashkëpunues draftin e planit vjetor të punës dhe buxhetin, për komentet e tyre në lidhje me të dhe për miratim, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para fillimit të vitit përkatës të Programit. Nëse as Fondi, as institucioni bashkëpunues nuk bëjnë komente në lidhje me draftin e planit vjetor të punës dhe buxhetin brenda 30 ditësh pas marrjes së tij, drafti i planit vjetor të punës dhe buxheti do të konsiderohen të miratuar.

g) Fondi Financiar për Zonat Malore do të adoptojë draftin e planit vjetor të punës dhe buxhetin kryesisht në formën e pranuar nga Fondi dhe institucioni bashkëpunues dhe Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të sigurojë kopje të tij për Fondin dhe institucionin bashkëpunues, para fillimit të vitit përkatës të Programit.

h) Nëse kërkohet, Fondi Financiar për Zonat Malore mund të propozojë rregullime në draftin e planit vjetor të punës dhe buxhetin gjatë vitit përkatës të Programit, të cilat do të bëhen efektive me miratimin nga Fondi dhe institucioni bashkërendues.

SEKSIONI 3.03 Llogaritë e programit. (a) Sa më parë që të jetë e mundur pas datës së kësaj, por në asnjë rast më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës efektive, Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të hapë dhe më pas do të menaxhojë, në një bankë tregtare të propozuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme nga Fondi, dy llogari rrjedhëse, një të caktuar në lek dhe një në dollarë amerikanë për operacionet e Programit ("Llogaria në lek e Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore" dhe "Llogaria në dollarë amerikanë e Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore", së bashku të referuara si "Llogaritë e Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave

Malore"). Llogaria në dollarë amerikanë e Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore do të përdoret për të marrë Huanë dhe fonde të tjera dhe do të shfrytëzohet gjithashtu për: (i) marrjen e likuiditetit paraprak nga llogaria speciale e Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore; (ii) parafinancimi i llogarisë në lek të Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore; (iii) kryerjen e pagesave për përdoruesit e shërbimit dhe këshilluesit për shërbime kontraktuale; dhe (iv) kryerjen e pagesave për furnizuesit dhe kontraktuesit për mallra, punë civile dhe shërbime. Llogaria në lek e Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore do të përdoret për të marrë Huanë dhe fonde të tjera dhe do të shfrytëzohet gjithashtu për: (i) marrjen e likuiditetit paraprak nga llogaria në dollarë amerikanë e Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore; (ii) marrjen e kontributit financiar të Huamarrësit nga Thesari; (iii) marrjen e kontributit financiar të komunitetit për investime mbi infrastrukturën; (iv) kryerjen e pagesave për përdoruesit e shërbimit dhe këshilluesit për shërbime kontraktuale. (v) kryerjen e pagesave për furnizuesit dhe kontraktuesit për mallra, punë civile dhe shërbime; dhe (vi) kryerjen e pagesave për stafin drejtues të zyrës së Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe kostot operacionale. Llogaritë e Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore do të mbrohen nga kompensimi ose konfiskimi mbi kushtet e propozuara nga Huamarrësi dhe të pranuara nga Fondi. Drejtori ekzekutiv dhe menaxheri financiar i Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore do të caktohen si nënshkrues të autorizuar të llogarive të Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe të dy nënshkruesit do të kërkohen për të gjitha transaksionet e llogarive.

b) Sa më parë që të jetë e mundur pas datës së kësaj, por në asnjë rast më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës efektive, Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të hapë dhe më pas do të menaxhojë në një bankë tregtare të propozuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme nga Fondi për çdo zyrë të rrjetit MADA, një llogari rrjedhëse të caktuar në lek për operacionet e Programit ("Llogaria e zyrës së rrjetit MADA", së bashku të referuara si "Llogaritë e zyrave të rrjetit MADA") të cilat do të përdoren për të marrë Huanë dhe fonde të tjera dhe do të shfrytëzohet gjithashtu për: (i) marrjen e likuiditetit paraprak nga llogaria në lek e Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore; (ii) kryerjen e pagesave për përdoruesit e zyrave të rrjetit MADA si dhe për koston operative; dhe (iii) në varësi të përvojës dhe performancës, kryerjen e pagesave për koston e investimeve, menaxhimin e kontributeve financiare të përfituesit, si dhe për mobilizimin e financimeve nga burime të tjera. Llogaritë e zyrave të rrjetit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore do të mbrohen nga kompensimi ose konfiskimi mbi kushtet e propozuara nga Huamarrësi dhe të pranuara nga Fondi. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore, sa më parë që të jetë e mundur pas datës së kësaj, por në asnjë rast më vonë se 60 ditë pas datës efektive do të këshillojë Fondin për dy nënshkruesit e autorizuar të llogarive të zyrave të rrjetit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe të dy nënshkruesit do të kërkohen njëkohësisht për të gjitha transaksionet e llogarive të zyrave të rrjetit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore.

c) Sa më parë që të jetë e mundur pas datës së kësaj, por në asnjë rast më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës efektive, MAFF do të hapë dhe më pas do të menaxhojë në një bankë tregtare të propozuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme nga Fondi, dy llogari rrjedhëse, një të caktuar në lek dhe një në dollarë amerikanë për operacionet e Programit ("Llogaria në lek e MAFF" dhe "Llogaria në dollarë amerikanë e MAFF", së bashku të referuara si "Llogaritë e Programit të MAFF"), të cilat do të përdoren për të marrë Huanë dhe fonde të tjera dhe do të shfrytëzohet gjithashtu për: (i) marrjen e likuiditetit paraprak nga llogaria Speciale e MAFF; (ii) parafinancimin e llogarive në lek në nivel rrethi; (iii) kryerjen e pagesave për përdoruesit e shërbimit dhe këshilluesit për shërbime kontraktuale; (iv) kryerjen e pagesave për furnizuesit dhe kontraktuesit për mallra, punë civile dhe shërbime; dhe (v) kryerjen e pagesave për stafin drejtues të zyrës së MAFF dhe kostot operacionale. Llogaritë e Programit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore do të mbrohen nga kompensimi ose konfiskimi mbi kushtet e propozuara nga Huamarrësi dhe të pranuara nga Fondi. Drejtori ekzekutiv dhe menaxheri financiar i MAFF do të caktohen si nënshkrues të autorizuar të llogarive të Programit të MAFF dhe të dy nënshkruesit do të kërkohen për të gjitha transaksionet e llogarive.

SEKSIONI 3.04. Disponibiliteti i të ardhurave të Huasë. Huamarrësi do të vërë në dispozicion të agjencive të programit drejtues të ardhurat e Huasë, në përputhje me planin vjetor të punës dhe buxhetin dhe marrëveshjen mbështetëse financiare të Fondit Financiar për Zonat Malore për të zbatuar Programin.

SEKSIONI 3.05. Disponibiliteti i burimeve shtesë. (a) Përveç të ardhurave të Huasë, Huamarrësi do t'u mundësojë agjencive të programit drejtues gjatë periudhës së zbatimit të Programit,

sa më shpejt që të nevojitet, këto fonde, facilitete, shërbime dhe burime të tjera, siç mund të kërkohen herë pas here për të zbatuar Programin në përputhje me këtë Marrëveshje.

b) Pa kufizuar parimin e përgjithshëm të paragrafit (a) më sipër, Huamarrësi:

i) do të sigurojë që financimi nga bashkëfinancuesit e tjerë i marrë nga ai të vihet në dispozicion të agjencive të programit drejtues, në përputhje me planet vjetore të punës dhe buxhetin; dhe

ii) Huamarrësi do të vërë në dispozicion të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore gjatë periudhës së zbatimit të Programit, fonde homologe nga burimet e veta, në përputhje me procedurat e aplikueshme kombëtare për asistencë zhvillimi.

SEKSIONI 3.06. Prokurimi. Të gjitha prokurimet e financuara nga Huaja do të kryhen në përputhje me shtojcën 4 të Marrëveshjes së Huasë.

SEKSIONI 3.07 Data e përfundimit të Programit. Huamarrësi do të përfundojë zbatimin e Programit në datën ose përpara datës së përfundimit të Programit.

Neni 4

Raportimi dhe informacioni në lidhje me zbatimin

SEKSIONI 4.01 Monitorimi. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi Financiar për Zonat Malore do të krijojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, por në asnjë rast jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës efektive, dhe më pas të ruajnë një sistem menaxhimi informacioni të përshtatshëm, në përputhje me "Direktivat për monitorimin dhe vlerësimin e Projektit" të Fondit, për ta mundësuar atë të monitorojë Programin në përputhje me seksionin 8.02 (Monitorimi i zbatimit të Projektit) të kushteve të përgjithshme, bazuar në indikatorët e rënë dakord midis Huamarrësit dhe Fondit dhe do të përfshijë indikatorët e kërkuar nga rezultatet e Fondit dhe sistemi i menaxhimit të ndikimit (RIMS).

SEKSIONI 4.02 Raportet e ecurisë. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi Financiar për Zonat Malore do t'i dorëzojnë Fondit dhe institucionit bashkëpunues raporte ecurie gjashtëmujore dhe vjetore në lidhje me zbatimin e Programit, siç kërkohet nga seksioni 8.03 (raportet e ecurisë) të kushteve të përgjithshme, jo më vonë se gjashtë javë pas mbarimit të secilës prej periudhave përkatëse gjatë periudhës së zbatimit të Projektit.

SEKSIONI 4.03 Rishikimi afatmesëm. (a) Jo më vonë se tridhjetë e gjashtë muaj pas datës efektive, Huamarrësi, agjencitë e programit drejtues, Fondi, bashkëfinancuesit dhe institucioni bashkëpunues do të kryejnë një rishikim të zbatimit të Programit (Rishikimi afatmesëm), bazuar në termat e referencës të përgatitura nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi Financiar për Zonat Malore dhe të rëna dakord reciprokisht nga Huamarrësi, Fondi dhe institucioni bashkëpunues. Mes të tjerash, rishikimi afatmesëm do të shqyrtojë arritjen e objektivave të Programit dhe kufizimet mbi të, dhe të rekomandojë këtë riorientim siç mund të kërkohet për të arritur këto objektiva dhe për të hequr këto kufizime. Në veçanti, rishikimi afatmesëm do të shqyrtojë: (i) përqindjen e disbursimit dhe ecurinë e zbatimit përkundrejt llogaritjeve të vlerësimit dhe planeve vjetore të punës e buxhetit; (ii) Operacionet bankare të bankës së re dhe menaxhimi financiar i Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondit Financiar për Zonat Malore; (iii) paraqitja profesionale dhe menaxhimi financiar i siguruesve të kontraktuar të shërbimit; (iv) ndikimi mbi përfituesit siç matet nga indikatorët e përdorur në studimin kryesor të vlerësimit përkatës të fazës; dhe (v) rishikimi i asistencës teknike dhe programeve të trajnimit. Rishikimi afatmesëm do të informojë gjithashtu në lidhje me kushtet sipas të cilave, Fondi Financiar për Zonat Malore dhe institucioni pasardhës i saj do të vazhdojnë të tërheqin fonde Huaje, dhe kushtet e ndonjë huaje të re shtese të financuar nga Fondi për komponentët e zbatuar nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore.

b) Huamarrësi do të sigurojë që rekomandimet që rrjedhin nga rishikimi afatmesëm të zbatohen brenda një kohë të specifikuar në të dhe në funksion të Fondit. Është rënë dakord dhe kuptuar që këto rekomandime mund të rezultojnë në modifikime ndaj dokumenteve të Huasë ose anulimit të Huasë.

SEKSIONI 4.04. Raporti përfundimtar. Huamarrësi do t'i dorëzojë Fondit dhe institucionit bashkëpunues raportin përfundimtar në lidhje me Programin, siç kërkohet nga seksioni 8. 04 (raporti përfundimtar) të kushteve të përgjithshme, jo më vonë së gjashtë muaj pas datës së

përfundimit të Projektit.

SEKSIONI 4.05 Vlerësimet. Huamarrësi dhe secila Palë e Programit do të lehtësojnë vlerësimet dhe rishikimet e Programit që Fondi mund të kryejë gjatë periudhës së zbatimit të Programit dhe për dhjetë vjet pas kësaj, siç kërkohet nga seksioni 10. 05 (Vlerësimet e Projektit) të kushteve të përgjithshme.

Neni 5

Raportimi dhe informacioni financiar

SEKSIONI 5.01. Deklaratat financiare. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi Financiar për Zonat Malore do të përgatisin deklarata të qëndrueshme financiare të operacioneve, burimeve dhe shpenzimeve në lidhje me Programin, siç e kërkon seksioni 9.02 (Deklaratat financiare) të kushteve të përgjithshme për sa i përket çdo viti fiskal dhe t'i dorëzojnë Fondit dhe institucionit bashkërendues këto deklarata financiare brenda tre muajsh, në fund të çdo viti fiskal.

SEKSIONI 5.02. Raportet e kontrollit financiar. (a) Brenda nëntëdhjetë (90) ditësh të datës efektive, Huamarrësi do të caktojë, me miratimin paraprak të Fondit, revizorë financiarë të pavarur të zgjedhur nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondit Financiar për Zonat Malore, në përputhje me procedurat dhe kriteret në përmbajtje të "Udhëzimeve mbi kontrollet financiare të Projektit" (për përdorim të Huamarrësit) të Fondit, për të bërë kontroll financiar të deklaratave financiare në lidhje me Programin për dy vitet e para fiskale. Pas kësaj, sa më shpejt që të jetë e mundur, por në asnjë rast jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas fillimit të çdo viti të mëpasshëm fiskal, Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondit Financiar për Zonat Malore, me miratimin paraprak të Fondit, do të konfirmojë këtë emërim të revizorit financiar ose të emërojë revizorë të rinj financiare të pavarur për këtë vit fiskal.

b) Revizorët financiare të mësipërm, midis të tjerash, kontrollojnë: (i) deklaratat e qëndrueshme financiare në lidhje me Programin; (ii) procedurat kontraktuese të Programit për partnerët e Programit; dhe (iii) përgjegjësinë e Partnerëve të Programit, si dhe menaxhimin e burimeve të Programit nga partnerët zbatues të mësipërm.

c) Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi Financiar për Zonat Malore do të kenë deklarata të qëndrueshme financiare në lidhje me Programin, të kontrolluara financiarisht çdo vit fiskal nga këta revizorë financiarë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit financiar, siç mund të amendohen herë pas here. Në përputhje me seksionin 9.03 (Kontrolli financiar i llogarive) të kushteve të përgjithshme, përveç raportit të kontrollit financiar rreth deklaratave financiare, revizorët do të sigurojnë: (i) një opinion mbi deklaratat e certifikuara të shpenzimeve dhe operacionit të llogarive speciale; dhe (ii) një dokument të veçantë menaxhimi që adreson mjaftueshmërinë e kontabilitetit dhe sistemeve të brendshme të kontrollit. Huamarrësi do t'i dorëzojë sa më sipër Fondit dhe institucionit bashkëpunues brenda një periudhe gjashtëmujore pas mbarimit të çdo viti fiskal. Huamarrësi do t'i dorëzojë Fondit përgjigjen për dokumentin e menaxhimit të revizorëve brenda një muaji pas marrjes së saj.

Neni 6

Zgjidhjet ligjore të Fondit

SEKSIONI 6.01. Pezullimi. (a) Fondi mund të pezullojë, plotësisht ose pjesërisht, të drejtën e Huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga llogaria e Huasë në përputhje me seksionin 12.01 të kushteve të përgjithshme (pezullimi prej Fondit), me ndodhjen e ndonjërës prej ngjarjeve të parashtruara në të ose me ndodhjen e ndonjërës prej ngjarjeve të mëposhtme:

i) Statuti i Fondit Financiar për Zonat Malore dhe/ose Karta e Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore apo ndonjë dispozitë e tyre janë kundërshtuar, pezulluar, përfunduar, amenduar ose modifikuar pa miratimin paraprak të Fondit dhe Fondi ka vendosur që ky kundërshtim, pezullim, përfundim, amendim ose modifikim ka pasur ose ka të ngjarë të ketë një efekt të rëndë material mbi Programin;

ii) Çdo autoritet kompetent ka marrë masa për shpërbërjen e Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe/ose Fondit Financiar për Zonat Malore ose pezullimin e operacioneve të tyre ose ka filluar ndonjë masë ose procedim për shpërndarjen e aseteve të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe/ose Fondit Financiar për Zonat Malore, midis kreditorëve të tyre.

b) Fondi mund të pezullojë të drejtën e Huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga llogaria e Huasë nëse kontrolli financiar i kërkuar në përputhje me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme nuk është realizuar në mënyrë të kënaqshme brenda dymbëdhjetë (12) muajve prej datës së raportimit financiar, pa paragjykuar dispozitat e në seksionin 6.04 të Marrëveshjes së Huasë.

SEKSIONI 6.02 Anulimi. Fondi mund të përfundojë, të drejtën e Huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga llogaria e Huasë në përputhje me seksionin 12.02 të kushteve të përgjithshme (Anulimi prej Fondit), me shfaqjen e ndonjërës prej ngjarjeve të parashtruara në të ose rishikimi në mes të periudhës së Projektit e ka rekomanduar një gjë të tillë.

SEKSIONI 6.03 Përshpejtimi i maturimit. Fondi mund të deklarojë pagesën e menjëhershme të principalit të mbetur të Huasë bashkë me interesat dhe tarifat e shërbimit ende të pashlyera mbi të në përputhje me seksionin 12.05 të kushteve të përgjithshme (Përshpejtimi i maturimit), me shfaqjen e ndonjërës prej ngjarjeve të parashtruara në të.

SEKSIONI 6.04. Kontrollet financiare. Nëse Huamarrësi nuk paraqet në kohë raportin e kontrollit financiar të kërkuar sipas seksionit 5.02, dhe nëse Fondi, pas konsultimit me Huamarrësin, vendos që Huamarrësi nuk do ta bëjë këtë brenda një periudhë të arsyeshme kohë pas kësaj, Fondi ose institucioni bashkëpunues në emër të Fondit, mund të angazhojnë revizorë financiarë, sipas zgjedhjes së tyre, për të kontrolluar llogaritë në lidhje me Programin. Për këtë qëllim, Huamarrësi dhe Palët e Programit do të vënë në dispozicion të këtyre revizorëve të dhëna financiare dhe të dhëna të tjera menjëherë sipas kërkesës, t'u japin atyre të drejta dhe privilegje të plota si agjentë të Fondit sipas seksionit 10.03 (Vizita, inspektime dhe hetime) të kushteve të përgjithshme dhe të bashkëpunojnë plotësisht me këtë kontroll financiar. Me përfundimin e tij, Fondi do të vërë menjëherë në dispozicion të Huamarrësit raportin e kontrollit financiar. Kështu, Huamarrësi autorizon Fondin të financojë kostot e këtij kontrolli financiar me tërheqjen nga llogaria e Huasë në emër të Huamarrësit.

SEKSIONI 6.05 Zgjidhje të tjera ligjore. Zgjidhjet ligjore të Fondit të parashtruara në këtë nen nuk do të kufizojnë ose ndryshe të paragjykojnë ndonjë të drejtë ose trajtim tjetër të disponueshëm për Fondin sipas kushteve të përgjithshme ose ndonjë dispozitë tjetër.

Neni 7

Hyrja në fuqi

SEKSIONI 7.01. Kushte që paraprijnë hyrjen në fuqi. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 8 të kushteve të përgjithshme (Hyrja në fuqi dhe përfundimi), duke iu nënshtruar përmbushjes paraprakisht të kushteve të mëposhtme:

a) Kjo Marrëveshje do të jetë nënshkruar dhe nënshkrimi dhe performanca e saj nga Huamarrësi do të jetë autorizuar dhe ratifikuar nga i gjithë mekanizmi i nevojshëm qeveritar administrativ; dhe

b) Huamarrësi do t'i dorëzojë Fondit një opinion ligjor të favorshëm, të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë të Huamarrësit në lidhje me çështjet e parashtruara në seksionin 7.02 në të dhe në formën e thelbin e pranuar nga Fondi.

c) Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të ketë riformuar bordin ekzekutiv në përputhje me paragrafin 1 të shtojcës 3.

d) Huamarrësi, Fondi Financiar për Zonat Malore dhe Fondi do të kenë rënë dakord në lidhje me programin e zbatimit për ristrukturimin e Fondit Financiar për Zonat Malore.

e) Bordi ekzekutiv i Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore, pas një procesi konkurrues dhe transparent rekrutimi do të ketë emëruar një drejtor ekzekutiv sipas kushteve të pranuara nga Fondi.

f) Huamarrësi do të ketë emëruar një drejtor ekzekutiv, nga Fondi Financiar për Zonat Malore me miratimin paraprak të Fondit dhe

g) Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të ketë kontraktuar staf profesional me miratimin paraprak të Fondit.

SEKSIONI 7.02. Opinioni ligjor. Opinioni ligjor i kërkuar sipas seksionit 7.01 do të

trajtojë në mënyrë të favorshme çështjet e mëposhtme:

a) përmbushjen e kushtit të mëparshëm të specifikuar në seksionin 7.01 (a); dhe nëse

b) kjo Marrëveshje është ligjërisht detyruese mbi Huamarrësit, në përputhje me kushtet e saj, pavarësisht nga ndonjë ligj i kundërt në territorin e saj, dhe mbështetet nga besimi i plotë dhe mirëbesimi i Huamarrësit.

SEKSIONI 7.03 Afati i fundit për hyrjen në fuqi. Nëse kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi brenda 90 ditësh pas datës së këtushme ose ndonjë datë tjetër siç mund të përcaktojë Fondi, Fondi mund ta përfundojë këtë Marrëveshje dhe dokumentet e tjera të Huasë siç parashikohet në seksionin 13.03 të kushteve të përgjithshme (Përfundimi përpara hyrjes në fuqi).

Neni 8
Të ndryshme

SEKSIONI 8.01 Përfaqësuesi. Ministri i Financave të Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 15.03 (Autoriteti që ndërmerr veprime) të kushteve të përgjithshme.

SEKSIONI 8.03 Statusi i kësaj Marrëveshjeje. Huamarrësi dhe Fondi bien dakord që kjo Marrëveshje përbën një traktat ndërkombëtar për të gjitha qëllimet sipas së drejtës ndërkombëtare.

SEKSIONI 8.04 Komunikimet. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe në dokumentet e Huasë ose kërkohet nga Fondi, Huamarrësi do t'i adresojë të gjitha komunikimet në lidhje me këtë Marrëveshje si te Fondi, ashtu edhe tek institucioni bashkëpunues, me përjashtim të:

SEKSIONI 8.05 Adresat. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për të gjitha njoftimet, kërkesat, raportet dhe komunikimeve të tjera që jepen apo bëhen në këtë Marrëveshje:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financës
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri
Numri i faksit: (35542) 28494 (35542) 29200
Kopje për: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri
Numri i faksit: (33542) 28362 (33542) 28442

Për Fondin: Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor
Via del Serafico, 107, 00142 Romë, Itali
Numri i faksit: (3906) 5043463

Për institucionin bashkëpunues:
Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS)
405 Lexington Avenue, 4th Floor, New York, N.Y. 10174, U.S.A.
Numri i faksit: (1212) 4574001 (1212) 4574002 (1212) 4574003
Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS)
Rome Office, FAO Building E, 1st Floor, Viale delle Terme di Caracalla, 00100, Rome, Italy
Numri i faksit: (3906) 570502929

SEKSIONI 8.06 Gjuha e komunikimit. Të gjitha njoftimet, kërkesat, raportet, dokumentet dhe informacione dhe komunikime të tjera që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje, Huanë dhe Programin do të jenë në gjuhën angleze.

Në dëshmi të sa më sipër, palët që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në _____ në datë dhe vitin e shkruar më sipër.

SHTOJCA 1
PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

1. Zona ku do të zbatohet Programi. Programi do të zbatohet në rajonet e Bulqizës, Devollit,

Dibrës, Gjirokastrës, Gramshit, Hasit, Kolonjës, Korçës, Kukësit, Librazhdit, Përmetit, Pogradecit, Pukës, Malësisë së Madhe, Matit, Mirëditës, Shkodrës, Skraparit, Tepelenës, Tropojës dhe Vlorës ose ndonjë rajoni tjetër, siç mund të jetë rënë dakord midis Huamarrësit dhe Fondit në territorin e Huamarrësit (Zona e Programit).

2. Grupi në fokus të Programit. Përfituesit e këtij Programi do të jenë familjet e varfra në zonat malore të territorit të Huamarrësit.

3. Qëllimi. Qëllimi i Programit është rritja e të ardhurave të familjeve në komunitetet e zonës malore, veçanërisht midis shtresave më të varfra të popullsisë rurale.

4. Komponentët. Programi do të ketë katër komponentë, tre për t'u realizuar nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe i katërti nëpërmjet Fondit Financiar për Zonat Malore. Tre komponentët që kanë lidhje me Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore do të jenë: (a) zhvillimi i programit rajonal; (b) zhvillimi i sektorit privat; dhe (c) implementimi në terren dhe testimi i metodave të investimit. Komponenti që ka lidhje me Fondin Financiar për Zonat Malore do të konsistojë në shndërrimin e tij në një bankë bujqësore tërësisht kompetente, transformimin dhe zgjerimin e Fondit Financiar për Zonat Malore.

5. Komponenti i zhvillimit të programit rajonal do të konsistojë në mbështetje ndaj: (a) ndërtimit të rrjeteve dhe nxitjen për të krijuar Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore në komunitetin ndërkombëtar të organizatave të specializuara që merren me zhvillimin ekonomik në zonat më pak të favorizuara dhe për të mobilizuar burimet e mëtejshme dhe nxitjen e investimeve nga brenda; (b) studime, analiza dhe politika kërkimore për krijimin e Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore, si një dije bazë në rrafsh kombëtar në zonat malore; dhe (c) forcimin e komuniteteve për të marrë pjesë në zhvillimin e tyre, që do të përfshijë: (i) ndërtimin e kapacitetit midis administratave të qeverisë lokale për të planifikuar dhe zbatuar investimet e zhvillimit të qëndrueshëm; (ii) krijimin e një fondi për të siguruar kontribute të përputhshme granti drejt kostos së mikroprojekteve prioritare në lidhje me komunitetin; dhe (iii) mbështetjen e zhvillimit të mëtejshëm të forumeve të zonës malore në nivel rajonal dhe kombëtar.

6. Komponenti i zhvillimit të sektorit privat do të konsistojë në mbështetjen ndaj: (a) zhvillimit të biznesit dhe lidhjes financiare, duke përqasur bizneset emergjente me tipe të ndryshme të siguruesve të shërbimit të zhvillimit të biznesit që operojnë në zonat rurale dhe institucionet financiare përkatëse formale dhe informale; (b) vazhdimësisë së përpunimit që është pjesë e programeve të investimit strategjik, për të informuar bizneset aktuale ose të mundshme në lidhje me mundësitë e investimit optimal, bazuar në analizat e zinxhirëve të produktit/vlerës; dhe (c) ndërtimit të kapacitetit të forcës punëtore nëpërmjet mbështetjes për institucionet arsimore kombëtare për sa i përket trajnimit teknik të grave dhe të rinjve në rastet kur aftësitë e përshtatshme janë identifikuar si një kufizim kryesor në programet e investimit strategjik.

7. Komponenti i zbatimit në terren dhe i testimit të metodave të investimit do të sigurojë mbështetje për dërgimin aktual të investimeve të zhvillimit që janë identifikuar më tepër nëpërmjet programeve të investimit strategjik. Fillimisht, komponenti do të përfshijë mbështetje ndaj: (a) infrastrukturës ekonomike në shkallë të ulët nëpërmjet granteve kontribuese për rinovimin/ndërtimin e infrastrukturës rurale të shkallës së ulët që ka treguar të jetë një kufizim kritik ndaj zhvillimit të biznesit në lokalitet; (b) novacioneve teknologjike nëpërmjet dhënies së granteve kontribuese konkurruese drejt investimeve të lidhura me cilësinë e produktit dhe cilësinë e kontrollit, higjienën dhe sigurinë e ushqimeve, markimin e produktit dhe marketingun; dhe (c) koordinimit dhe dërgimit të shërbimeve veterinare publike që trajtojnë kontrollin e brucelozës te kafshët e vogla ripërtypëse.

8. Komponenti i transformimit dhe zgjerimit të fondit financiar për zonat malore do të sigurojë mbështetje ndaj Fondit Financiar për Zonat Malore për shndërrimin e tij në fund të periudhës së zbatimit të Programit, nga statusi aktual si fondacion publik, në një bankë të licencuar tregtare bujqësore, duke siguruar zgjerimin e shërbimeve financiare, duke nxitur kështu zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në komunitetet rurale malore. Ky shndërrim, duke ndjekur kërkesat e Bankës së Shqipërisë, do të kalojë tre faza: një periudhë përgatitore para marrjes së një licence parabankare; një periudhë paralicensimi; dhe pas kësaj operimi si një bankë tregtare bujqësore. Ndërsa ofron shërbime bankare për një publik më të gjerë, banka e re do t'i përmbahet fokusit të zonës rurale dhe malore të Fondit Financiar për Zonat Malore. Pikat e rëndësishme për t'u arritur do të përfshijnë: (a) sistemet bankare të përshtatshme të kompjuterizuara, tërësisht operacionale në bankën e re; (b) një sërë produktesh financiare bujqësore të përshtatshme, në dispozicion të klientëve; (c) degët bankare që

operojnë në zonat rurale; (d) klientët ruralë që depozitojnë kursime në mënyrë aktive me bankën e re; dhe (e) shumica e aksioneve pa interesa fikse të bankës në zotërim të klientëve të vegjël privatë dhe investitorëve strategjike institucionale. Për të arritur këto synime, Programi do të mbështesë pesë aktivitete: (a) zhvillimin e pronësisë dhe strukturës së qeverisjes; (b) rrjetin e degës dhe zhvillimin e rrjetit të zgjeruar; (c) zhvillimin e burimeve njerëzore; (d) zhvillimin e produkteve; dhe (e) zhvillimin e sistemeve.

SHTOJCA 2
ALOKIMI DHE TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË HUASË

Alokimi i të ardhurave të Huasë (a) Tabela e mëposhtme paraqet kategoritë e shpenzimeve të pranueshme që do financohen nga Huaja, alokimin e shumave të Huasë në çdo kategori dhe përqindjet e shpenzimeve për zërat që do financohen në çdo kategori:

	Kategoria	Sasia e alokuar e Huasë (E shprehur në SDR)	Përqindja e shpenzimeve të pranueshme që do financohen
I	Punët civile A. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (a) Investimet prioritare për komunitetin (b) Mbështetje e infrastrukturës (c) Rehabilitimi i ndërtesave/zyrës B. Fondi Financiar për Zonat Malore	 120 000 270 000 5000 490 000	 50% neto e taksave 10% neto e taksave 100% neto e taksave 100% neto e taksave
II	Pajisjet e mallrave dhe automjete Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore Fondi Financiar për Zonat Malore	 60 000 470 000	 100% neto e taksave 100% neto e taksave
III	Asistenca teknike dhe shërbimet profesionale A. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore	 710 000	 100% neto e taksave
IV	Rrjetet e trajnimit dhe uorkshopet Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore Fondi Financiar për Zonat Malore	 80 000 690 000	 100% neto e taksave 100% neto e taksave
V	Grantet Korresponduese/SIP (Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore)	670 000	75% neto e taksave
VI	Huaja rritëse (Fondi Financiar për Zonat Malore)	1040 000	100% neto e taksave
VII	Kostot periodike (Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore)	610 000	80% (PY1), 70 % (PY2), 50% (PY3), 0% (me pas), gjithë përqindja neto e taksave
VIII	Të paalokuara	285 000	
	TOTALI	5 500 000	

b) Fondi mund të rregullojë tabelën e mësipërme, si të jetë e nevojshme, për t'i mundësuar ushtrimin e të drejtave të tij sipas seksionit 6.04. Fondi do të njoftojë Huamarrësin në lidhje me këtë rregullim dhe ky njoftim do të cilësohet *ipso facto* për të modifikuar këtë Marrëveshje.

2. Sasia minimale e tërheqjes. Tërheqjet nga llogaria e Huasë do të bëhen në sasira jo më të vogla sesa 20 000 dollarë amerikanë ose vlerat ekuivalente me të apo këto sasira të tjera mund të bëhen siç i cakton Fondi herë pas here.

3. Deklaratat e shpenzimeve. Tërheqjet nga llogaria e Huasë mund të bëhen përkundrejt deklaratave të shpenzimeve në lidhje me shpenzimet e pranueshme në sasira të tilla siç Fondi mund t'i caktojë herë pas here, duke njoftuar Huamarrësin. Nuk është nevoja që të dhënat që

tregojnë këto shpenzime t'i dorëzohen Fondit, por do të ruhen nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi Financiar për Zonat Malore, për inspektim nga përfaqësuesit e Fondit dhe institucionit bashkëpunues, në përputhje me seksionet 4.07 (Deklaratat e shpenzimeve) dhe 10.03 (Vizita, inspektime dhe hetime) të kushteve të përgjithshme.

4. Kushtet e mëparshme të tërheqjeve. Asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me shpenzimet sipas kategorisë VI derisa Marrëveshja Mbështetëse Financiare e Fondit Financiar për Zonat Malore të jetë miratuar nga Fondi në draft; një kopje e kësaj Marrëveshjeje Mbështetëse Financiare të Fondit Financiar për Zonat Malore, siç është nënshkruar nga Huamarrësi dhe Fondi Financiar për Zonat Malore, kryesisht në formën e miratuar dhe certifikuar si e vërtetë dhe e përfunduar nga një zyrtar kompetent i Fondit Financiar për Zonat Malore, do t'i dorëzohet Fondit; nënshkrimi dhe performanca e së cilës nga Huamarrësi dhe Fondi Financiar për Zonat Malore do të autorizohen ose ratifikohen nga i gjithë mekanizmi i përbashkët administrativ dhe qeveritar dhe kur të jenë plotësuar gjitha kushtet e mëparshme të efektivitetit të saj.

SHTOJCA 3
ZBATIMI I PROGRAMIT

ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

1. Investimet e mbështetura sipas Programit do të jenë të integruara në përgjegjësitë administrative të institucioneve të specializuara të krijuara nga dokumentet qeveritare sipas programit të mëparshëm të investimit të IFAD-it- MADP. Për t'i dhënë më tepër peshë metodave të decentralizuara pjesëmarrëse për stimulimin e rimëkëmbjes rurale dhe zhvillimit ekonomik, bordi ekzekutiv i Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore do të ristrukturohet nën drejtimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ose ndonjë kryesie tjetër siç njoftohet nga Huamarrësi dhe miratuar nga Fondi. Anëtarësia e bordit do të modifikohet për të reflektuar rolin kryesor të agjencisë si promotor të zhvillimit ekonomik në sektorin privat, në një mjedis zhvillimi të rritjes së demokratizimit dhe decentralizimit. Interesat e sektorit privat do të përfaqësohen nëpërmjet Shoqatës së Bankiereve, Dhomës (Dhomave) të Tregtisë dhe përfaqësuesi (t)/përfaqësuesve të zgjedhur të shoqatave kryesore të prodhuesve/tregtuesve. Interesat e shoqërisë civile do të përfaqësohen nga personat e zgjedhur nga niveli rajonal i Forumit të Zonës Malore - i zgjedhur me rotacion nga secila prej katër zonave operacionale të Zyrave të Rrjetit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore - dhe, ka të ngjarë, nga forumi i nivelit kombëtar që është krijuar. Interesat e sektorit publik në nivelet kyçe të qeverisë lokale do të përfaqësohen nga zgjedhja e një anëtari bordi nga komunat e zonës malore dhe një anëtar nga rajonet (përsëri me rotacion nga katër zonat operacionale të Zyrave të Rrjetit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore). Në nivel kombëtar, ministritë do të përfaqësohen në nivel drejtorësh, për të përfshirë në instancën e parë Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Financave.

2. Selia e Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe katër zyrat e rrjetit që do të krijohen, do të zbatojnë komponentë që kanë lidhje me Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore: (a) zhvillimin e programit rajonal; (b) zhvillimin e sektorit privat; dhe (c) implementimin në terren dhe testimin e metodave të investimit. Selia e Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore do të ristrukturohet për të reflektuar mandatin e saj të ri dhe për të zgjeruar edhe mënyrën e operimit.

3. Stafi drejtues i Fondit Financiar për Zonat Malore do të jetë përgjegjës për ristrukturimin e tij në një bankë tregtare bujqësore. Fondi Financiar për Zonat Malore do të rekrutojë staf kryesor shtesë, të diktuar nga kërkesat praktike të operacioneve bankare të reja, me komplekse, që të kenë kualifikimet minimale për menaxheret e bankave tregtare, siç kërkohen nga Banka e Shqipërisë. Një përfaqësim i propozuar nga një investitor strategjik ndërkombëtar mbi bordin e drejtorëve do të kërkojë të sigurojë faktin që ristrukturimi i fondit financiar për zonat malore të ndjekë planet e miratuara.

4. Marrëveshja Mbështetëse Financiare e Fondit Financiar për Zonat Malore. Huadhënësi dhe Fondi Financiar për Zonat Malore do të hyjnë në një marrëveshje (Marrëveshja Mbështetëse Financiare e Fondit Financiar për Zonat Malore"), e cila do të sigurojë, midis të tjerash që:

a) Huadhënësi do të transferojë fondet në dispozicion për transformimin dhe zgjerimin e Fondit Financiar për Zonat Malore, në përputhje me planin dhe buxhetin vjetor të punës dhe sipas kushteve të pranuara nga Fondi; dhe

b) Fondi Financiar për Zonat Malore do të deklarojë angazhimin e tij për synimin dhe qëllimet e Programit siç deklarohet në Programin 1, në vazhdim të këtij synimi dhe këtyre qëllimeve.

MANUALET E PROGRAMEVE

5. Manualet e zbatimit të Programit

5.1 Përgatitja. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të përgatisë manuale të zbatimit të draftprogramit sa më shpejt dhe praktikisht që të jetë e mundur, por në asnjë rast jo më vonë se 90 ditë pas datës efektive. Manualet e zbatimit të draftprogramit do të përfshijnë, midis të tjerash, kriteret për dhëniet e grantit konkurrues (domethënë skemat korresponduese të grantit për komunat; grantet e infrastrukturës ekonomike; dhe grantet e novacioneve teknologjike).

5.2. Miratimi. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do t'i dorëzojë për miratim bordit ekzekutiv të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore manualet e zbatimit të draftprogramit.

5.3 Adoptimi. Bordi ekzekutiv do të adoptojë manualet e zbatimit të Programit kryesisht në formën e miratuar nga Fondi dhe Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore do të sigurojë menjëherë kopje për Fondin dhe institucionin bashkëpunues. Nëse as Fondi, as institucioni bashkëpunues nuk bëjnë komente në lidhje me manualet e zbatimit të draftprogramit brenda 30 ditësh pas marrjes, ato do të konsiderohen të miratuara.

SHTOJCA 3A
MARRËVESHJET SHTESË

1. Praktikat e menaxhimit të insekteve të dëmshme. Si pjesë të ruajtjes së praktikave mjedisore të shëndetshme, siç kërkohet nga seksioni 7.15 i kushteve të përgjithshme, Palët e Programit do t'i përmbahen praktikave të përshtatshme të menaxhimit të insekteve të dëmshme sipas Programit dhe, për këtë qëllim, Huadhënësi do të sigurojë që pesticidet e marra sipas Programit të mos përfshijnë ndonjë pesticid të ndaluar nga Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) mbi Shpërndarjen dhe Përdorimin e Pesticideve, siç amendohet herë pas here ose listuar në tabelat 1 (të rrezikut jashtëzakonisht të lartë) dhe 2 (të rrezikut të lartë) të klasifikimit të rekomanduar të WHO në lidhje me pesticidet sipas rrezikut dhe klasifikimit të periudhës 1996-1997, siç amendohet herë pas here.

2. Sigurimi i personelit të Programit. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi Financiar për Zonat Malore do të sigurojnë të gjithë anëtarët kryesorë të personelit të Programit kundër rreziqeve shëndetësore dhe aksidenteve në masën që është e pajtueshme me praktikat e aplikuara kombëtare.

3. Rishikimi afatmesëm. (a) Synimet treguese që do të arrihen nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore në kohën e rishikimit afatmesëm për të informuar në lidhje me angazhimin e qeverisë për të kërkuar fonde huaje të reja shtesë nga Fondi ose paraqitja te bordi i tij ekzekutiv për komponentë që kanë lidhje me Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore, do të përfshijnë:

i) kuadrin institucional të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore, i riorganizuar dhe i përshtatshëm- duke përfshirë zyrën funksionale të rrjetit;

ii) evidencë të një burimi të zgjeruar fondi orientuar për operacionet e sponsorizuara nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore; dhe

iii) planifikim programi dhe sisteme e procedura analize që operojnë në përputhje me dispozitat në këtë Marrëveshje.

b) Synimet treguese që duhet të arrihen nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore në kohën e rishikimit afatmesëm për të informuar mbi aksesin e mëtejshëm në fondet e huasë për komponentin që ka lidhje me Fondin Financiar për Zonat Malore do të përshijnë:

i) dhënien e licencës bankare;

ii) rritjen e portofolit në përputhje me rritjen e portofolit dhe planin e financimit;

iii) karakterizimin e huamarrësve-në përshtatje me fokusin e Programit mbi uljen e varfërisë në zonat malore; dhe

iv) përshtatjen në pronësinë e bankës në përputhje me projektimin e përbashkët.

4. Gjinia. Gjinia do të merret në konsideratë në lidhje me:

a) mbledhjen dhe analizën e të dhënave për strukturat dhe proceset socio-ekonomike të rajonit të zonave malore;

b) mundësi të barabarta gjinore për përfaqësimin në bordin ekzekutiv të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore;

c) mundësi të barabarta gjinore për personat që depozitojnë llogari kursimesh, huamarrësit, klientët/aksionarët e Fondit Financiar për Zonat Malore/bankës së re;

d) mundësi të barabarta gjinore brenda SIP;

e) mundësi të barabarta gjinore për pjesëmarrësit në forumet e zonave malore rajonale dhe kombëtare;

f) njohjen dhe konsiderimin e qartë të nevojave dhe shqetësimeve të zhvillimit të grave të zonave malore në procesin e politikëbërjes rajonale; dhe

g) sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të Programit do të përfshijë (ku të jetë e mundur), duke zbërthyer të dhënat në bazë gjinie.

SHTOJCA 4
PROKURIMET

Seksioni A . Të përgjithshme

1. Të gjitha të mirat, punimet ndërtimore dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua do të prokurohen në përputhje me dispozitat "Udhëzues për prokurimet e kryera në funksion të Asistencës Financiare të Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor" (1982) si dhe me dispozitat që mund të amendohen herë pas here nga Fondi (Udhëzuesi i prokurimeve). Nëse ndonjë nga udhëzuesit e prokurimit nuk është në përputhje me një dispozitë të kësaj liste, kjo e fundit do të ketë përparësi.

2. Në shkallën e mundshme, mallrat, punët civile dhe shërbimet do të zgjerohen në paketa të konsiderueshme tenderimi në mënyrë të tillë që të lejojnë përdorimin optimal të tenderimit konkurrues. Para fillimit të prokurimit, Huamarrësi do t'i japë institucionit bashkërendues për miratim: (a) një listë ose listat e mallrave dhe shërbimeve që do prokurohen; (B) grupimin e propozuar të këtyre mallrave dhe shërbimeve; dhe (c) numrin e propozuar dhe fushën e veprimit të kontratave të punëve civile që do të jepen.

3. Prokurimi do të zhvillohet vetëm gjatë periudhës së zbatimit të Programit dhe në përputhje me planet e prokurimit të miratuara nga Fondi.

4. Nuk do të zhvillohet asnjë prokurim, nëse ai përfshin një pagesë për persona ose ente, apo një importim mallrash, të ndaluar me një vendim të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara të marrë sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Fondi do të informojë Huamarrësin në lidhje me këta persona, ente apo këtë importim.

5. Kufiri i përcaktuar në këtë Shtojcë 4 përfshin edhe taksat.

Seksioni B. Metodat e prokurimit të të mirave

6. Blerja Lokale. Kontratat për sigurimin e të mirave dhe pajisjeve që vlerësohen të kushtojnë deri në US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër mund të jepen bazuar në vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të sjella nga të paktën tre furnizues në përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e miratuara nga institucioni bashkëpunues.

7. Kontraktimi i drejtpërdrejtë. Kontratat për sigurimin e të mirave dhe pajisjeve speciale që vlerësohen të kushtojnë deri në US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër mund të jepen bazuar në kontraktimin e drejtpërdrejtë me kontraktorin apo furnizuesin në përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e miratuara nga institucioni bashkëpunues.

8. Tenderi konkurrues i brendshëm. Kontratat për sigurimin e të mirave dhe pajisjeve që vlerësohen të kushtojnë më tepër se US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër mund të jepen bazuar në tenderimin e brendshëm konkurrues të shpallur në masmedian lokale në përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e miratuara nga institucioni bashkëpunues.

Seksioni C. Metodat e prokurimit të punimeve ndërtimore

9. Blerja lokale. Kontratat për sigurimin e punimeve ndërtimore që vlerësohen të kushtojnë deri në US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër mund të jepen bazuar në vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të sjella nga të paktën tre furnizues në përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e miratuara nga institucioni bashkëpunues.

10. Tenderi konkurrues i brendshëm. Kontratat për sigurimin e punimeve ndërtimore që vlerësohen të kushtojnë më tepër se US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër mund të jepen bazuar në tenderimin e brendshëm konkurrues të shpallur në masmedian lokale në

përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e miratuara nga institucioni bashkëpunues.

Seksioni D. Metodat e prokurimit të shërbimeve

11. Blerja lokale. Kontratat për sigurimin e shërbimeve që vlerësohen të kushtojnë deri në US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër mund të jepen bazuar në vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të sjella nga të paktën tre furnizues në përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e miratuara nga institucioni bashkëpunues.

12. Blerja ndërkombëtare. Kontratat për sigurimin e shërbimeve që vlerësohen të kushtojnë deri në US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër mund të jepen bazuar në vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të sjella nga të paktën tre furnizues në përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e miratuara nga institucioni bashkëpunues.

13. Tenderi konkurrues i brendshëm. Kontratat për sigurimin e shërbimeve speciale që vlerësohen të kushtojnë më tepër se US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër mund të jepen bazuar në tenderimin e brendshëm konkurrues të shpallur në masmedian lokale në përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e miratuara nga institucioni bashkëpunues.

Seksioni E. Rishikimi i vendimeve të prokurimit

14. Dhënia e çdo kontrate për të mira apo punime ndërtimore me një kosto prej jo më pak se US$50,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër si dhe çdo kontrate për shërbime komplekse (i.e. projektimi dhe zbatimi i SIP), do të jetë subjekt i rishikimit paraprak nga institucioni bashkëpunues në përputhje me udhëzuesit e prokurimit.

15. Dhënia e çdo kontrate për shërbime me një kosto prej jo më pak se US$25,000 ose ekuivalentin e kësaj shume në një monedhë tjetër, do të jetë subjekt i procedurave të rishikimit siç mund të ketë vendosur në mënyrë të vazhdueshme institucioni bashkëpunues për kontrata të tilla në projekte dhe programe të tjera të ngjashme.

16. Në lidhje me ndonjë kontratë tjetër për mallra, punë civile apo shërbime, Huamarrësi do t'i sigurojë institucionit bashkërendues dy kopje të certifikuara ose konform të kësaj kontrate, së bashku me analizën e tenderave përkatës dhe rekomandimet për dhënie, menjëherë pas nënshkrimit të saj para dorëzimit tek institucioni bashkërendues të aplikimit të parë për tërheqjen e fondeve nga llogaria e Huasë në lidhje me këtë kontratë.

17. Para rënies dakord mbi ndonjë modifikim ose heqje dorë nga kushtet e ndonjë kontrate të referuar në paragrafët 14 dhe 15 sa më sipër, ose dhënien e një zgjatjeje të periudhës kohore të parashtruar për kryerjen e kësaj kontrate, ose nxjerrjen e ndonjë urdhri ndryshimi sipas kësaj kontrate (përveçse në rastet e urgjencës së jashtëzakonshme) që do të rrisnin koston e kontratës me më shumë se 10 % të çmimit fillestar, Huamarrësi do të informojë institucionin bashkërendues në lidhje me modifikimin, heqjen dorë, zgjatjen e afatit ose urdhrin e ndryshimit të propozuar dhe arsyet përkatëse. Nëse institucioni bashkërendues vendos që propozimi nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, do të informojë menjëherë Huamarrësin dhe deklarojë arsyet për vendimin e saj.

LIGJ
Nr.9606, datë 11.9.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2004 "PROGRAMI I SEKTORIT TË ENERGJISË", ME NJË GRANT PREJ 9 000 000 EUROSH"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2004 “Programi i sektorit të energjisë”, me një grant prej 9 000 000 (nëntë milionë) eurosh”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5056, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2004 “PROGRAMI I SEKTORIT TË ENERGJISË”

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit Financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 2 dhjetor 2004;

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrin nga Kreditansalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, shuma financimi me vleftë prej gjithsej deri 9 000 000 euro (nëntë milionë euro) për projektet e përmendura më poshtë:

a) “Programi i sektorit të energjisë (Nxitja e efiçencës lidhur me energji dhe e energjive të përtëritshme)” deri në 7 000 000 euro (shtatë milionë euro).

b) “Masa shoqëruese për programin e sektorit të energjisë” deri në 2 000 000 euro (dy milionë euro).

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projektet e përmendura në paragrafin 1 mund të zëvendësohen me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditansalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të përmendura në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen ndërmjet Kreditansalt für Wiederaufbau dhe marrësve të shumave të financimit, kontrata të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundon brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron

më datë 31 dhjetor 2012.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditansalt für Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafi 4.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditansalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe atyre që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 1.6.2006 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

LIGJ
Nr.9607, datë 11.9.2006

PËR KËSHILLIN KONSULTATIV TË BIZNESIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Këshilli Konsultativ i Biznesit (KKB) është organ këshillimor i Këshillit të Ministrave për zhvillimin e politikave ekonomike dhe për përmirësimin e kuadrit ligjor përkatës.

Neni 2
Objekti i veprimtarisë

1. Objekti i veprimtarisë së Këshillit Konsultativ të Biznesit është përgatitja e rekomandimeve për Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin, nëpërmjet dialogut shtet-privat në:

a) procesin e hartimit të strategjive dhe të programeve qeveritare të zhvillimit të ekonomisë;

b) procesin e përgatitjes së Buxhetit të Shtetit dhe të paketave fiskale;

c) politikat e privatizimit;

ç) politikat e prokurimit publik;

d) politikat e nxitjes së investimeve;

dh) politikat e zhvillimit të tregtisë dhe të biznesit;

e) politikat e konkurrencës, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

2. KKB-ja ia dërgon përfundimet dhe rekomandimet e saj Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit. Projektaktet e përgatitura nga institucionet qendrore të administratës, sipas objektivave të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, i dërgohen për mendim KKB-së.

Neni 3

Burimet e financimit

Burimet e financimit të KKB-së janë:

1. Buxheti i Shtetit.

2. Burime të tjera të ligjshme.

KREU II

PËRBËRJA, EMËRIMI I ANËTARËVE DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KONSULTATIV TË BIZNESIT

Neni 4

Përbërja e Këshillit Konsultativ të Biznesit

1. Këshilli Konsultativ i Biznesit kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues nga:

a) Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;

b) shoqatat e biznesit, vendase dhe të huaja;

c) shoqëria civile në fushën e biznesit;

ç) institucionet shtetërore;

d) organizmat e pushtetit vendor.

2. Këshilli Konsultativ i Biznesit përbëhet nga jo më pak se 15 dhe jo më shumë se 20 anëtarë, ku shumica i përket përfaqësuesve të biznesit. Kryetari e përfaqëson këtë Këshill në marrëdhënie me të tretët. KKB-ja vepron nëpërmjet komisioneve të këshillimit dhe sekretariatit teknik.

Neni 5

Mënyra e funksionimit

Mënyra e funksionimit dhe e përdorimit të fondeve financiare të KKB-së, komisioneve të këshillimit dhe sekretariatit teknik përcaktohen në rregulloren “Për funksionimin e Këshillit Konsultativ të Biznesit”.

Rregullorja e funksionimit të Këshillit Konsultativ të Biznesit miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 6

Emërimi i anëtarëve të Këshillit Konsultativ të Biznesit dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre

Anëtarët e Këshillit Konsultativ të Biznesit emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë për një periudhë 2-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje një herë, ndër tre kandidaturat e paraqitura nga institucioni përkatës, sipas nenit 4 pika 1 të këtij ligji.

Kriteret dhe procedurat e caktimit përcaktohen në rregulloren e funksionimit të këtij Këshilli.

Neni 7
Sekretariati teknik

Veprimtaria administrative e Këshillit Konsultativ të Biznesit realizohet nga sekretariati teknik, i cili emërohet nga Kryetari i këtij Këshilli.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5057, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9608, datë 18.9.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SUEDISË PËR AFATET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë për afatet dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit për zhvillim".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5058, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SUEDISË MBI AFATET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu quhet "Shqipëri") i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Mbretëria e Suedisë (këtu quhet Suedia) e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar Sida, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje përcakton afatet dhe kushtet e përgjithshme për bashkëpunimin e zhvillimit ndërmjet Shqipërisë dhe Suedisë.

Kushtet e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për shoqëritë, institucionet dhe organizatat joqeveritare të konsulencës, si dhe për persona të tjerë fizikë dhe juridikë nga vende të ndryshme nga Shqipëria, me kusht që:

- Puna e tyre të jetë e financuar nga fondet suedeze të bashkëpunimit për zhvillim, dhe
- Puna e tyre të jetë pjesë e projektit/programit të bashkëpunimit për zhvillimin ndërmjet Shqipërisë dhe Suedisë, sipas parashikimit në një marrëveshje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe Suedisë.

Neni 2
Përdorimi i burimeve

Burimet me financimin apo kontributin e Suedisë do të përdoren përjashtimisht për qëllimin e projekteve/programeve të bashkëpunimit për zhvillimin të rëna dakord ndërmjet Palëve.

Suedia dhe Shqipëria bien dakord të bashkëpunojnë për parandalimin e korrupsionit brenda dhe nëpërmjet projekteve/programeve. Suedia dhe Shqipëria marrin përsipër të marrin hapa të menjëhershëm ligjorë në vendet e tyre përkatëse për të ndaluar, hetuar dhe akuzuar çdo palë që për shkaqe të arsyeshme dyshohet për korrupsion apo shpërdorime të tjera të burimeve.

Përdorimi i fondeve të dhëna nga Suedia për qëllimet e rëna dakord nuk do të pengohen apo vonohen për shkak të kontrolleve apo tarifave të këmbimit valutor të caktuara nga Shqipëria. Nuk do të paguhen tarifa të tilla nga kontributet suedeze.

Suedisë nga Shqipëria nuk do t'i caktohet asnjë tarifë doganore, taksë shitjeje/taksë e tërthortë apo tarifa të tjera për mallrat apo burimet e tjera që jepen apo financohen nga Suedia. Nëse kërkohen tarifa apo shpenzime të tilla, ato paguhen nga Shqipëria.

Licencat e nevojshme për importet e financuara nga Suedia do të jepen menjëherë nga Shqipëria.

Shqipëria do t'i japë Suedisë çdo informacion mbi përdorimin e burimeve të dhëna nga Suedia që Suedia mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme dhe do t'u japë mundësi përfaqësuesve të Suedisë për të vizituar dhe studiuar aktivitetet dhe për të inspektuar pasurinë, mallrat, regjistrat dhe dokumentet.

Neni 3
Kushtet dhe procedurat për disbursimin

Kushtet dhe procedurat për disbursimin e fondeve të dhëna do të parashikohen në marrëveshje specifike që mbulojnë projektet/programet në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve

Rregullat dhe procedurat e zbatueshme për prokurimin e shërbimeve, mallrave dhe punëve do të parashikohen në marrëveshje specifike që mbulojnë projektet/programet sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5
Kushtet për institucionet dhe shoqëritë e huaja të konsulencës

Nëse shoqëritë e konsulencës, institucionet, organizatat joqeveritare apo persona të tjerë juridikë nga vende të ndryshme nga Shqipëria janë të kontraktuar nga Suedia për të kryer detyra në Shqipëri brenda kuadrit të bashkëpunimit për zhvillimin ndërmjet Suedisë dhe Shqipërisë, zbatohen si më poshtë:

5.1 Këta persona juridikë nuk do të mbahen përgjegjës për mosrealizimin e detyrave të tyre, nëse kjo është për shkak të udhëzimeve apo rekomandimeve në lidhje me sigurinë të dhëna nga Ambasada Suedeze dhe seksioni për bashkëpunimin për zhvillimin të akredituar në Shqipëri.

5.2 Ata do të kenë të drejtën të importojnë dhe rieksportojnë, pa paguar taksë doganore apo tarifa të ngjashme, pajisje profesionale dhe mallra që atyre u nevojiten për të kryer detyrën, apo t'i shesin këto pajisje në Shqipëri kundrejt pagesës së taksës doganore dhe tarifave të tjera, nëse nuk nevojiten më për dhënien e shërbimeve.

5.3 Ata do të përjashtohen nga taksat dhe tarifat e tjera mbi fitimet dhe xhiron e shoqërive apo për një shkak të ngjashëm, si dhe mbi tarifat dhe shpërblimet që u paguhen atyre nga Suedia për shërbimet e tyre brenda programit të bashkëpunimit për zhvillimin. Ky përjashtim nuk zbatohet për taksat e tërthorta të llojit që normalisht përfshihet në çmimin e mallrave dhe shërbimeve të blera në Shqipëri.

5.4 Ata do të kenë të drejtë të hapin llogari të jashtme bankare dhe t'i operojnë ato në përmbushje të detyrave të tyre. Trajtimi me efektivitet i llogarive nuk do të pengohet nga kontrollet e këmbimit valutor dhe balancat në këto llogari të jashtme do të jenë lehtësisht të transferueshme në çdo valutë të konvertueshme.

5.5 Ata përjashtohen nga të gjitha detyrimet për t'u regjistruar në Shqipëri për autorizime profesionale, taksa apo shkaqe të tjera dhe nuk e kanë detyrimin për t'u dhënë informacion organeve tatimore të Shqipërisë, përveç kur ato ushtrojnë aktivitete biznesi në Shqipëri që nuk përfshihen në objektin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Kushtet për personelin e huaj

6.1 Këto kushte zbatohen për ata persona fizikë që nuk kanë vendbanim të përhershëm në Shqipëri, duke përfshirë qytetarët e Shqipërisë, që:

i) po ushtrojnë detyra në Shqipëri brenda projektit/programit të bashkëpunimit për zhvillimin të financuar nga Suedia, me kusht që ata apo punëdhënësi i tyre të ketë një kontratë me Suedinë;

ii) janë bashkëshortë, persona që bashkëjetojnë apo të varur të personelit në pikën (i) të mësipërme.

6.2 Në rastin e ndalimit apo arrestit, për çfarëdolloj arsyeje, të çdo personi që mbulohet nga kjo Marrëveshje, apo në rastin e çështjes penale të nisur kundër një personi të tillë, Ambasada e Suedisë në Shqipëri do të njoftohet pa vonesë dhe do të ketë të drejtën të vizitojë personin e ndaluar apo arrestuar. Personi i ndaluar apo arrestuar do të ketë të drejtën të kontaktojë ambasadën e tij/saj ose të konsultohet dhe të ketë të drejtën të komunikojë me një avokat të caktuar nga ambasada e tij/saj apo nga vetë personi. Shqipëria i siguron çdo personi të mbuluar nga kjo Marrëveshje kushte të arsyeshme jetese në ndalim apo arrest.

6.3 Shqipëria mund të kërkojë tërheqjen apo zëvendësimin e çdo anëtari të personelit të dërguar nga Suedia, puna apo sjellja e të cilit mendohet të jetë e pakënaqshme.

Suedia mund të tërheqë çdo anëtar të personelit. Para marrjes së vendimit për tërheqjen, Suedia, përveç kur diktohet ndryshe nga arsye sigurie apo rrethana të tjera të veçanta, konsultohet për çështjen edhe me Shqipërinë në lidhje me masat për sigurimin e zëvendësimit të shpejtë të personelit të tërhequr.

6.4 Ligjet e Shqipërisë zbatohen për personelin, përveç kur është rënë dakord ndryshe në këtë apo marrëveshje të tjera ndërmjet Palëve.

Shqipëria i garanton personelit si më poshtë:

a) leje të menjëhershme dhe lëshimin e vizave pa pagesë, me shumë hyrje, rihyrje dhe dalje për të gjithë kohëzgjatjen e detyrës së tyre;

b) lëvizje të lirë brenda vendit dhe të drejtën për të hyrë dhe dalë nga vendi në masën e duhur për zbatimin e projektit/programit;

c) lëshimin e menjëhershëm të të gjitha lejeve dhe licencave të kërkuara, si lejen e qëndrimit, lejen e punës, lejen e kërkimit dhe lejet profesionale, si dhe përjashtimin nga kufizimet e emigrimit dhe regjistrimin e të huajve gjatë periudhave që mbulohen nga kjo Marrëveshje;

d) përjashtimin nga taksa e të ardhurave personale dhe taksat e tjera në lidhje me shpërblimet që u paguhen atyre nga Suedia, apo një punëdhënës që ka marrë përsipër të kryejë shërbimet dhe

shpërndajë mallrat në kontratë me Suedinë drejtpërdrejt apo si nënkonsulent;

e) të drejtën për shërbimet dhe ambientet mjekësore të cilësisë më të lartë që janë në vend, pavarësisht nëse shërbimet dhe ambientet janë publike apo private. Tarifat normale do të paguhen nga Suedia pas kryerjes së shërbimit. Shpenzimet financohen nga fondet suedeze për projektin/programin ku përfshihet personi përkatës;

f) mjetet ekuivalente të rikthimit në atdhe në rast krize kombëtare apo ndërkombëtare si ato që u jepen anëtarëve të misioneve diplomatike;

g) të drejtën për të importuar dhe rieksportuar, pa paguar tarifa doganore dhe tarifa të tjera, pajisjet profesionale dhe mallrat që i duhen personelit për të kryer detyrën e tij.

6.5 Personelit që shërben më shumë se gjashtë muaj i garantohet nga Shqipëria edhe sa më poshtë:

a) e drejta për të hapur dhe operuar një llogari bankare të jashtme në Shqipëri për nevojat e tyre personale, ku këto llogari nuk u nënshtrohen kontrolleve të këmbimeve valutore apo tarifave të caktuara nga Shqipëria dhe balancat janë lirisht të konvertueshme në korona suedeze apo çdo valutë tjerët të konvertueshme;

b) e drejta për të importuar apo blerë pajisjet shtëpiake dhe personale nga magazina pa doganë, duke mos paguar tarifë doganore apo tarifa të tjera.

Nëse një pajisje shtëpiake prishet në mënyrë të pariparueshme, kjo mund të zëvendësohet duke e importuar apo blerë pa paguar taksë doganore dhe tarifa.

Termi “pajisje shtëpiake dhe personale” përfshin për çdo ekonomi shtëpiake, produktet ushqimore dhe artikuj të tillë, si dy automjete, një gjenerator, një makinë larëse, një tharës, një lavastovilje, një sobë, një mikrovalë, kondicionerë, një frigorifer, një frigorifer ngrirës, pajisje të vogla elektrike, telefona celularë dhe kamera, një komplet pajisjesh fotografike dhe filmike, një video, një televizor, radio dhe pajisje muzikore dhe për përpunimin e të dhënave.

Nëse një automjet dëmtohet në aksident apo vidhet, apo nëse periudha e shërbimit në Shqipëri duhet të zgjatet për një periudhë prej të paktën dymbëdhjetë muaj tej çdo periudhe shërbimi trevjeçare, personi do të ketë të drejtën të importojë pa paguar doganë dhe tarifa një automjet për ta zëvendësuar.

Artikujt e importuar në këtë mënyrë mund t’u shiten personave të tjerë të cilët e kanë edhe vetë të drejtën e përjashtimit nga dogana dhe taksat apo të rieksportohen pa taksë doganore apo tarifa të ngjashme në fund të periudhës së shërbimit. Nëse artikujt e importuar në këtë mënyrë shiten në mënyrë tjetër, për to paguhet taksa doganore dhe tarifat e tjera përkatëse.

Neni 7

Përgjegjësia dhe rreziqet

Shqipëria merr përsipër të gjitha rreziqet që rrjedhin apo shkaktohen nga operacionet në Shqipëri në projektet/programet e bashkëpunimit të zhvillimit ndërmjet Suedisë dhe Shqipërisë.

Shqipëria, veçanërisht, do të jetë përgjegjëse për të trajtuar të gjitha pretendimet që mund të ngrihen nga palët e treta kundër shoqërive të konsulencës, institucioneve, organizatave joqeveritare apo personave të tjerë fizikë dhe juridikë për të cilët zbatohet kjo Marrëveshje që rrjedhin nga apo lidhen drejtpërdrejt me operacionet e kryera në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Pavarësisht parashikimit të nenit 1 të mësipërm, neni 7 zbatohet edhe për personat me vendbanim të përhershëm në Shqipëri, nëse ata janë të punësuar nga kushdo që rregullohet nga kjo Marrëveshje.

Shqipëria, në lidhje me këto pretendime, përballon të gjitha shpenzimet dhe paguan të gjitha dëmshpërblimet që i takojnë një pale të tretë. Në rastet kur provohet që është shkaktuar dëm nga subjektet e kësaj Marrëveshjeje gjatë kryerjes së detyrave të tyre si rezultat i neglizhencës serioze dhe sjelljes së qëllimshme dhe pas bisedimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Suedisë, Palët do të vendosin në lidhje me shpërblimin dhe kompensimin e Shqipërisë.

Shqipëria do të ketë të drejtën të ushtrojë dhe zbatojë avantazhin e çdo mbrojtjeje apo të drejte kompensimi të çdo kundërpretendimi, sigurimi, zhdëmtimi, kontributi apo garancie që i takon palës përkatëse. Suedia i jep Shqipërisë çdo asistencë që Shqipëria mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për ta bërë këtë.

Neni 8

Siguria

Shqipëria do të njoftojë Ambasadën e Suedisë në Shqipëri në lidhje me çdo situatë të jashtëzakonshme apo gjendje emergjence në vend. Në rast se njëra prej Palëve mendon se zhvillime të tilla përbëjnë forcë madhore apo rrezikojnë zbatimin e projekteve apo programeve të bashkëpunimit, secila prej Palëve mund të kërkojë konsultime të menjëhershme. Në këto konsultime Shqipëria do të japë informacion në lidhje me çdo rregull sigurie apo kufizimet e tjera që duhet të kihen parasysh nga shtetasit joshqiptarë.

Suedia, për arsye sigurie, mund t'i japë personelit udhëzime të veçanta. Këto udhëzime mund të përfshijnë urdhrat të largohen nga Shqipëria. Personeli që i përmbush udhëzimet apo që merr masa parandaluese që kërkohen në bazë të rrethanave nuk do të konsiderohen sikur nuk kanë përmbushur detyrën në bazë të kontratës.

Shpenzimet e shkaktuara nga Suedia për të siguruar sigurinë e personelit do të financohen nga fondet e dhëna nga Suedia për bashkëpunimin për zhvillimin me Shqipërinë.

Neni 9
Vizitat studimore etj. jashtë Shqipërisë

Për personelin nga Shqipëria që merr pjesë në vizita studimore, kurse dhe aktivitete të ngjashme profesionale jashtë Shqipërisë, të organizuara nga Suedia apo një person juridik i kontraktuar nga Suedia në kuadrin e bashkëpunimit suedez për zhvillimin, zbatohen sa më poshtë:

Në rast sëmundjeje apo aksidenti gjatë qëndrimit jashtë shtetit, Suedia do të marrë masa për atë trajtim mjekësor që është i nevojshëm para kthimit në Shqipëri, në pajtim me opinionin e një mjeku që konsultohet nga Suedia.

Të gjitha shpenzimet që lidhen me trajtimin, si dhe shpenzimet e siguracionit, do të financohen nga fondet e dhëna nga Suedia për bashkëpunimin për zhvillimin nëse domosdoshmëria e një trajtimi të tillë nuk do të mund të parashikohej në momentin e fillimit të vizitës.

Mbulimi i siguracionit në rast vdekjeje apo invaliditeti rregullohet nga Shqipëria.

Neni 10
Shpërndarja e kësaj Marrëveshjeje

Palët marrin përsipër të shpërndajnë kopje të kësaj Marrëveshjeje në të gjitha ministritë dhe organet e tyre përkatëse, si dhe institucionet e tjera që përfshihen në bashkëpunim apo që u duhet informacion në lidhje me përmbajtjen e saj.

Neni 11
Gjuha

Janë nënshkruar katër origjinale të tekstit të kësaj Marrëveshjeje, të shkruara në anglisht dhe shqip. Versionet anglisht dhe shqip janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhje në interpretim, mbizotëron versioni anglisht.

Neni 12
Hyrja në fuqi dhe shfuqizimi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi kur Suedia të ketë marrë njoftim me shkrim nga Shqipëria ku të konfirmohet përfundimi i procedurave të brendshme shqiptare të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht nga data e nënshkrimit në atë masë që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të mos bien në kundërshtim me legjislacionin e Suedisë apo Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi derisa të shfuqizohet nga njëra Palë, duke bërë njoftim me shkrim me një afat gjashtëmujor.

Tiranë, më 30.6.2006

LIGJ
Nr.9609, datë 18.9.2006

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7971, DATË 26.7.1995
"PËR PROKURIMIN PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pas shkronjës "b" të nenit 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) Procedurat e këtij ligji nuk zbatohen për prokurimin e shkëmbimit e të shitjes së energjisë elektrike te furnizuesit, vendas e të huaj.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5059, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9610, datë 18.9.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT PËR SHËRBIMIN AJROR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit për shërbimin ajror".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5060, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE SHËRBIMI AJROR
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit, që këtu quhen "Palët Kontraktuese";

duke qenë palë në Konventën për Aviacion Ndërkombëtar Civil të hapur për nënshkrim në Çikago më 17 dhjetor 1944; dhe

duke njohur rëndësinë e transportit ajror si një mjet për krijimin dhe mbajtjen e miqësisë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet popujve të të dy vendeve; dhe

duke dashur të nxisin zhvillimin e transportit ajror ndërmjet Shqipërisë dhe Izraelit dhe të ofrojnë në masën më të plotë bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë; dhe

duke dashur të lidhin një marrëveshje për operimin e shërbimeve ajrore ndërmjet dy territoreve;

janë marrë vesh për sa më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e interpretimit dhe zbatimit të marrëveshjes, përveç kur është parashikuar ndryshe në të:

a) Termi "Konventë" do të thotë - Konventa e aviacionit ndërkombëtar civil të hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944 dhe përfshin çdo shtojcë të miratuar në bazë të nenit 90 të kësaj Konvente, çdo ndryshim të shtojcave ose Konventës në bazë të nenit 90 dhe 94 të saj, nëse këto shtojca dhe ndryshime kanë hyrë në fuqi për ose janë ratifikuar nga të dyja Palët Kontraktuese;

b) Termi "autoritete aeronautike" do të thotë në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe në rastin e shtetit të Izraelit, Ministër i Transportit ose në të dyja rastet çdo person ose organ që mund të jetë i autorizuar të kryejë funksione që tashmë ushtrohen nga autoritetet e sipërpërmendura apo funksione të ngjashme;

c) Termi "shoqëri ajrore e përcaktuar" është një shoqëri ajrore që secila Palë Kontraktuese ka përcaktuar për të operuar shërbimet e parashikuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje;

d) Termi "territor" në lidhje me Republikën e Shqipërisë dhe shtetin e Izraelit ka kuptimin e parashikuar në nenin 2 të Konventës;

e) Termat "shërbim ajror", "shërbim ajror ndërkombëtar", "shoqëri ajrore" dhe "ndalesë jo për qëllime trafiku" kanë kuptimin e parashikuar në nenin 96 të Konventës;

f) Termi "Marrëveshje" do të thotë kjo Marrëveshje, shtojcat e saj dhe çdo ndryshim të saj, që formon një pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje;

g) Termi "Shtojcë" do të thotë shtojca e kësaj Marrëveshjeje ose me ndryshimet në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2 të nenit 20 të kësaj Marrëveshjeje;

h) Termi "itinerare të përcaktuara" do të thotë itinerare të përcaktuara ose që do të përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje;

i) Termi "shërbime të rëna dakord" do të thotë shërbimet ajrore ndërkombëtare të kryera nga avionët e transportit publik të pasagjerëve, mallrave dhe postës, që mund të operohen në itineraret e përcaktuara në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes;

j) Termi "tarifat e përdorimit" do të thotë një tarifë që u caktohet shoqërive ajrore nga autoritetet kompetente ose lejohet prej tyre të caktohet për vënien në dispozicion të pasurisë ose pajisjeve, duke përfshirë shërbimet dhe pajisjet përkatëse për avionët, ekuipazhin, pasagjerët dhe mallrat e tyre;

k) Termi "tarifë" do të thotë çmimet që paghen për transportin e pasagjerëve, bagazheve dhe mallit si dhe kushtet për agjenci dhe shërbime të tjera dytësore, por duke përjashtuar pagesat ose kushtet për agjenci dhe shërbime të tjera dytësore në lidhje me transportin e postës;

l) Termi “kapacitet” në lidhje me “shërbimet e rëna dakord” do të thotë kapaciteti i avionit të përdorur në një periudhë të caktuar kohe dhe në një itinerar apo pjesë itinerari;

m) Termi “ndalim i ndërmjetëm” është një ndërprerje e qëllimshme e një udhëtimi nga një pasagjer, të rënë dakord paraprakisht nga shoqëria apo shoqëritë ajrore në një pikë ndërmjet pikës së fillimit dhe pikës së destinacionit.

Neni 2
Dhënia e të drejtave

1. Çdo Palë Kontraktuese i jep Palës jetër Kontraktuese të drejtat e parashikuara në këtë Marrëveshje, për qëllimet e krijimit dhe operimit të shërbimeve të planifikuara ajrore ndërkombëtare në itineraret e parashikuara në shtojcën e saj.

2. Nëse nuk është parashikuar ndryshe në këtë Marrëveshje ose në shtojcën e saj, shoqëria ajrore e përcaktuar nga secila Palë Kontraktuese gëzon të drejtat e mëposhtme:

a) të fluturojë pa u ulur mbi territorin e Palës tjetër Kontraktuese;

b) të bëjë ndalesa në këtë territor për qëllime jo trafiku;

c) gjatë operimit të një shërbimi të rënë dakord në itineraret e caktuara, të embarkojë dhe disbarkojë në Palën tjetër Kontraktuese duke caktuar shoqërinë ajrore; dhe

d) të embarkojë dhe disbarkojë në territorin e sheteteve të treta, në pikat e rëna dakord në përputhje me parashikimet e shtojcës së kësaj Marrëveshjeje, pasagjerët, bagazhin, mallin dhe postën që vjen ose është e destinuar për territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet sikur i jep shoqërisë ajrore të caktuar të një prej Palëve Kontraktuese privilegjin e marrjes në bord në territorin e Palës tjetër Kontraktuese pasagjerë, mall apo postë për ta transportuar me pagesë ose shpërblim të destinuar për një pikë tjetër në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

4. Shoqëritë ajrore të secilës Palë Kontraktuese, të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 3 të Marrëveshjes gëzon gjithashtu të drejtat e parashikuara në paragrafin 2 a) dhe b) të këtij neni, me kusht që të jenë marrë paraprakisht autorizimet e duhura nga autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3
Shoqëritë ajrore të përcaktuara dhe autorizimi i operimit

1. Secila Palë Kontraktuese ka të drejtën të përcaktojë me shkrim për Palën tjetër Kontraktuese një shoqëri ajrore për qëllimet e operimit ndërmjet territoreve të të dy vendeve shërbimet e rëna dakord në itineraret e përcaktuara.

2. Me marrjen e një përcaktimi të tillë, Pala tjetër Kontraktuese i jep shoqërisë së përcaktuar autorizimin përkatës të operimit pa vonesë, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Autoritetet e aeronautikës të një Pale Kontraktuese mund t’i kërkojë shoqërisë ajrore të përcaktuar nga Pala tjetër Kontraktuese të provojë që ajo i përmbush kushtet e parashikuara në bazë të ligjit përkatës që zbatohet normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme në operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga këto autoritete në përputhje me dispozitat e Konventës.

4. Secila Palë Kontraktuese ka të drejtën të refuzojë dhënien e autorizimit të operimit të parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni ose të caktojë ato kushte që mund t’i konsiderojë të nevojshme në lidhje me ushtrimin nga shoqëria ajrore e përcaktuar e të drejtave të parashikuara në nenin 2 të Marrëveshjes në çdo rast kur kontrolli përkatës i kësaj linje ajrore i është caktuar Palës Kontraktuese që përcakton shoqërinë ajrore ose shtetasve të saj.

5. Pasi shoqëria ajrore të jetë përcaktuar dhe autorizuar në këtë mënyrë, ajo mund të fillojë të operojë shërbimet e rëna dakord, me kusht që shoqëria ajrore të përmbushë dispozitat e zbatueshme të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Revokimi ose pezullimi i të drejtave

1. Secila Palë Kontraktuese ka të drejtën të revokojë një autorizim operimi ose të pezullojë ushtrimin e të drejtave të parashikuara në nenin 2 të Marrëveshjes që i janë dhënë shoqërisë ajrore të përcaktuar nga Pala tjetër Kontraktuese, ose të imponojë ato kushte që mund t'i konsiderojë të nevojshme për ushtrimin e këtyre të drejtave:

a) në rastet kur ajo nuk është e bindur që pronësia thelbësore dhe kontrolli efektiv i shoqërisë ajrore nuk i takon Palës Kontraktuese që ka përcaktuar shoqërinë ajrore apo shtetasve të kësaj Pale Kontraktuese, ose

b) në rastin e mosrespektimit nga kjo shoqëri ajrore të ligjeve dhe rregulloreve të Palës Kontraktuese që ka dhënë këto të drejta, ose

c) në çdo rast në të cilin shoqëria ajrore nuk kryhen shërbimet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e parashikuara në Marrëveshje.

2. Përveç kur revokimi, pezullimi ose imponimi i kushteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni është thelbësor për të parandaluar shkeljen e mëtejshme të ligjit dhe rregulloreve, kjo e drejtë ushtrohet vetëm pas konsultimeve me Palën tjetër Kontraktuese.

Neni 5

Përjashtimi nga tarifat dhe taksat

1. Bazuar në parimin e reciprocitetit, secila Palë Kontraktuese e liron shoqërinë ajrore të Palës tjetër Kontraktuese në masën më të gjerë të mundur në bazë të ligjit të brendshëm dhe detyrimeve ndërkombëtare nga kufizimet e importit, tarifat doganore, taksat e ushtrimit, tarifat e inspektimit dhe tarifa dhe pagesa të tjera për furnizimet, pjesët e këmbimit duke përfshirë motorat, pajisjet e zakonshme të avionit, avionët e shoqërisë ajrore të përcaktuar të kësaj Pale Kontraktuese që operon shërbimet e rëna dakord, si dhe stokun e biletave të printuara, letrat shoqëruese të mallit, çdo material të printuar që përmban logon e kompanisë të printuar mbi të dhe materialin e zakonshëm të reklamave që shpërndahet pa pagesë nga shoqëria ajrore e përcaktuar.

2. Përjashtimi i parashikuar nga ky nen zbatohet për sendet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni:

a) që futen në territorin e një Pale Kontraktuese nga ose në emër të shoqërisë ajrore të përcaktuar të Palës tjetër Kontraktuese;

b) që mbahen në bordin e avionit të shoqërisë ajrore të përcaktuar të një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese gjatë mbërritjes ose largimit nga territori i Palës tjetër Kontraktuese;

c) që merren në bordin e avionit të shoqërisë ajrore të një Pale Kontraktuese dhe janë të destinuara për t'u përdorur në operimin e shërbimeve, pavarësisht nëse këto sende përdoren apo konsumohen plotësisht apo pjesërisht brenda territorit të Palës Kontraktuese që lejon përjashtimin, me kusht që këto sende të mos shiten në territorin e Palës Kontraktuese.

Sendet e përmendura në a), b) dhe c) më sipër mbahen nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e doganës.

3. Pajisjet e rregullta të ngritjes së avionit në ajër, si dhe materialet, furnizimet dhe pjesët e këmbimit të mbetura në bordin e avionit të vënë në punë nga shoqëria (të) ajrore e përcaktuara të secilës Palë Kontraktuese mund të shkarkohen në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese vetëm me miratimin e autoriteteve doganore të atij territori. Në të tilla kushte, ato mund të zëvendësohen nën mbikëqyrjen e autoriteteve në fjalë deri në kohën kur ato do të rieksportohen ose do t'u jepet një zgjidhje tjetër në përputhje me rregullat doganore të Palës së fundit Kontraktuese.

4. Përjashtimet për artikujt e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni do të jenë të vlefshme në linjën ajrore të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 6

Tarifat

1. Tarifat që do të përcaktohen nga një shoqëri ajrore e njërës Palës Kontraktuese për

transportin nga dhe për në territorin e Palës tjetër Kontraktuese do të vendosen në nivele të arsyeshme duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët përkatës përfshirë këtu interesin e përdoruesve, koston e operimit, fitimin e arsyeshëm, tarifat e përcaktuara prej shoqërive të tjera ajrore dhe konsideratat e tregut. Palët Kontraktuese do të konsiderojnë si tarifa të papranueshme diskriminuese dhe përfituese tarifat që janë më të larta ose më kufizuese se normat e lejuara për shkak të abuzimit me pozicionin në treg, si dhe tarifat që janë artificialisht më të ulëta për shkak të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë ose indirekte përmes mbështetjes ose subvencioneve shtetërore.

2. Tarifat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni mund të përcaktohen individualisht nga secila shoqëri ajrore e përcaktuar dhe do t'i paraqiten për miratim nga ose në emër të kësaj shoqërie ajrore autoriteteve aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e propozuar për hyrjen e tyre në fuqi (ose brenda një periudhe më të shkurtër nëse autoritetet aeronautike të lartpërmendura bien dakord për ta ulur këtë kufi kohor),

3. Tarifat e depozituara në këtë formë mund të miratohen në çdo kohë nga autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese. Subjekt i dispozitave të mëposhtme, në qoftë se autoritetet aeronautike të Palëve nuk kanë shprehur mosmiratimin e tyre me shkrim për tarifat e propozuara brenda njëzet (20) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, tarifat do të konsiderohen të miratuara në ditën e njëzet e një (21) pas depozitimit të kërkesës në lidhje me miratimin e një tarife të caktuar.

4. Asgjë në paragrafin 3 më sipër nuk do të frenojë autoritetet aeronautike të një Pale Kontraktuese që në mënyrë të njëanshme të mos lejojnë tarifa të caktuara të depozituara nga një shoqëri ajrore e përcaktuar nga kjo Palë Kontraktuese.

5. Nëse autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese konsiderojnë se një tarifë e kërkuar e depozituar pranë tyre nga një shoqëri ajrore e përcaktuar nga Pala tjetër Kontraktuese është përtej normales ose se zbatimi i saj më pas do të përbënte një sjellje antikonkurruese që mund t'i shkaktonte dëme një shoqërie tjetër (ose shoqërive të tjera ajrore), ata mund të kërkojnë konsultime me Palën tjetër Kontraktuese brenda një periudhe njëzet (20)-ditore nga depozitimi i kërkesës nga kjo shoqëri ajrore. Këto konsultime do të përfundojnë brenda një periudhe njëzet e një (21)-ditore nga data e kërkesës për to dhe tarifa e kërkuar nuk do të hyjë në fuqi për sa kohë që për të nuk bien dakord autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese.

6. Tarifat e vendosura në përputhje me parashikimet e këtij neni do të mbeten në fuqi deri me vendosjen e tarifave të reja. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit më sipër, një tarifë e caktuar nuk do të vazhdojë të jetë në fuqi pas përfundimit të një periudhe dymbëdhjetë (12)-mujore pas datës që kjo tarifë nuk do të kishte pasoja ose do të kishte skaduar.

Neni 7

Përfaqësimi

1. Shoqërive ajrore të përcaktuara të çdo Pale Kontraktuese do t'u jepet e drejta e mbajtjes në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese të përfaqësuesve të tyre administrativë, tregtarë dhe stafit teknik të kërkuar me qëllim kryerjen e operimit të shërbimeve të miratuara. Stafi do të zgjidhet prej shtetasve të njërës apo të dyja Palëve Kontraktuese sipas rastit.

2. Këto kërkesa për stafin, në varësi të gjykimit të shoqërisë ajrore të përcaktuar, mund të plotësohen nga personeli i vet ose duke përdorur shërbimet e një organizate, shoqërie, ose shoqërie ajrore tjetër që operon në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, dhe që është autorizuar për të kryer këto shërbime në territorin e asaj Pale Kontraktuese.

3. Përfaqësuesit dhe stafi i shoqërive ajrore të përcaktuara do t'i nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, e cila mbështetur në parimin e reciprocitetit dhe pa vonesë do t'i garantojë përfaqësuesve dhe stafit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lejet e nevojshme të punës, vizat e punësimit apo dokumente të tjera të ngjashme.

4. Secila Palë Kontraktuese do të ndihmojë shoqëritë ajrore të përcaktuara të Palës tjetër Kontraktuese për krijimin e lehtësirave të kërkuara gjatë ngritjes së zyrave me qëllim kryerjen pa vonesë të operimit të shërbimeve të miratuara të shoqërive respektive ajrore të përcaktuara të Palëve Kontraktuese.

Neni 8

Zbatimi i ligjit dhe rregullave

1. Ligjet dhe rregullat e shtetit të secilës Palë Kontraktuese që rregullojnë pranimin në, qëndrimin në dhe largimin nga territori i këtij shteti, do të zbatohen për avionët e shoqërisë(ve) ajrore të përcaktuara nga Pala tjetër Kontraktuese të përfshirë në shërbimet ajrore ndërkombëtare apo për operimin dhe navigimin ajror të këtyre avionëve ndërsa është në territorin e këtij shteti.

2. Ligjet dhe rregulloret e shtetit të secilës Palë Kontraktuese, lidhur me pranimin në qëndrimin në dhe largimin nga territori i këtij shteti të pasagjerëve, ekuipazhit, ngarkesës dhe dërgesave postare, duke përfshirë rregulloret që kanë të bëjnë me imigrimin, emigrimin, pasaportat, taksat doganore dhe masat shëndetësore dhe sanitare, do të zbatohen për pasagjerët, ekuipazhin, ngarkesën dhe dërgesat postare të avionëve të shoqërisë ajrore të përcaktuara nga Pala tjetër Kontraktuese gjatë qëndrimit të tyre në territorin e këtij shteti.

Neni 9

Njohja e certifikatave dhe licencave

1. Certifikatat e aftësisë për fluturim, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara ose të bëra të vlefshme nga njëra Palë Kontraktuese që janë ende në fuqi, do të njihen si të vlefshme nga Pala tjetër Kontraktuese, duke siguruar se kërkesat sipas të cilave këto certifikata apo licenca janë lëshuar ose janë bërë të vlefshme janë të njëjta me ose mbi minimumin e standardeve të cilat janë ose mund të vendosen kohë pas kohe në përputhje me Konventën.

2. Secila Palë Kontraktuese rezervon gjithsesi të drejtën që të kundërshtojë njohjen e certifikatave të kompetencës dhe licencave të dhëna shtetasve të vet nga Pala tjetër Kontraktuese për qëllime të fluturimit mbi territorin e shtetit të vet.

Neni 10

Sigurimi në aviacion

1. Palët Kontraktuese riafirmojnë detyrimet e tyre ndaj njëri-tjetrit për mbrojtjen e sigurisë në aviacionin civil kundër akteve dhe ndërhyrjeve të paligjshme. Pa kufizuar të drejtat e tyre të përgjithshme dhe detyrimet sipas ligjit ndërkombëtar, Palët Kontraktuese, në veçanti do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Konventës për veprat penale dhe disa akte të tjera të kryera në bordin e avionit, nënshkruar në Tokio më 14 shtator të vitit 1963, Konventës për shtypjen e akteve të paligjshme kundër Sigurisë në Aviacionin Civil, nënshkruar në Montreal më 23 shtator 1971, si dhe të Protokollit për Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë, në Aeroportet Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, nënshkruar në Montreal më 24 shkurt 1988 në të cilat të dyja Palët Kontraktuese aderojnë.

2. Palët Kontraktuese do t'i sigurojnë njëri-tjetrës të gjithë ndihmën e nevojshme me qëllim parandalimin e akteve të rrëmbimit në aviacionin civil, si dhe të akteve të tjera të paligjshme kundër sigurisë së avionëve civilë, të pasagjerëve dhe ekuipazhit të tyre, të aeroporteve dhe pajisjeve të lundrimit ajror, si dhe ndaj çdo kërcënimi tjetër të sigurisë së aviacionit civil.

3. Palët Kontraktuese do të veprojnë në përputhje me parashikimet për sigurinë në aviacionin civil të vendosura nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar dhe shtojcat e Konventës deri në atë masë që këto parashikime sigurie janë të zbatueshme nga të dyja Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje. Palët Kontraktuese do t'u kërkojnë operatorëve të avionëve të regjistruar prej tyre apo operatorëve të avionëve të cilat kanë selinë kryesore të bisnesit apo rezidencën e tyre të përhershme në territorin e tyre, si dhe operatorëve të aeroporteve në territorin e tyre të veprojnë në përputhje me këto parashikime sigurie për aviacionin.

4. Palët Kontraktuese bien dakord se këtyre operatorëve të avionëve mund t'u kërkohet t'u binden parashikimeve të sigurisë së aviacionit të përmendura në paragrafin 3 më sipër të cilat kërkohen nga Pala tjetër Kontraktuese për pranimin në, qëndrimin në dhe largimin prej territorit të shtetit të Palës tjetër Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese do të marrë të gjitha masat e nevojshme që janë efektivisht të zbatueshme në territorin e shtetit të vet, për të mbrojtur avionin dhe për të inspektuar pasagjerët, ekuipazhin, transportin e materialeve, bagazhin, ngarkesën dhe rezervat përpara dhe përgjatë embarkimit apo mbushjes së mjetit ajror. Çdo Palë Kontraktuese do të konsiderojë

gjithshtu me dashamirësi çdo kërkesë të drejtuar nga Pala tjetër Kontraktuese për marrjen e masave të nevojshme të sigurisë për të përballuar kërcënime të llojit të veçantë.

5. Kur ndodh një incident apo ekziston rreziku për një incident të mundshëm të marrjes së paligjshme të një avioni civil apo akteve të tjera të paligjshme kundër sigurisë së një avioni, pasagjerëve dhe ekuipazhit të tij, aeroporteve apo mjeteve të lundrimit ajror, Palët Kontraktuese do të vijnë në ndihmë të njëra-tjetrës duke lehtësuar komunikimin dhe duke marrë masat e duhura me qëllim përfundimin e shpejtë e të sigurtë të kësaj situate kërcënuese apo incidenti sigurie.

6. Kur një Palë Kontraktuese ka arsye të besojë se Pala tjetër Kontraktuese nuk respekton standardet minimale të sigurisë së aviacionit të përcaktuara në këtë nen, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese mund të kërkojnë konsultime të menjëhershme në çdo kohë me autoritetet aeronautike të Palës së parë Kontraktuese.

7. Dispozitat zbatuese në lidhje me masat e posaçme të sigurisë që duhen zbatuar do të përcaktohen në marrëveshje ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 11

Shitjet dhe transferimi i tepricës së krijuar midis shpenzimeve dhe faturave

Në mbështetje të parimit të reciprocitetit:

1. Shoqëritë ajrore të përcaktuara të secilës Palë Kontraktuese do të jenë të lira të shesin shërbimet e transportit ajror në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese në monedhën lokale apo në çdo monedhë tjetër lehtësisht të këmbyeshme, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet agjentëve, subjekt i autorizimeve përkatëse nga autoritetet respektive të ngarkuara për këtë gjë.

2. Shoqëritë ajrore të përcaktuara të secilës Palë Kontraktuese kanë të drejtën e konvertimit lirisht në një monedhë lehtësisht të këmbyeshme, si dhe të transferimit të tepricës së fitimit që rezulton ndërmjet faturave të shitjes dhe shpenzimeve të kryera në lidhje me transportimin e pasagjerëve, bagazhit, ngarkesës dhe dërgesave të postës në territorin e shtetit tjetër. Këto transferta neto do të përfshijnë të ardhurat nga shitjet e kryera drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet një agjenti të shërbimit të transportit ajror. Pagesat do të bëhen në përputhje me parashikimet e marrëveshjes së posaçme ndërmjet Palëve Kontraktuese për pagesat nëse një marrëveshje e tillë ekziston, si dhe në rregullat financiare në fuqi të Palëve Kontraktuese aty ku ato ekzistojnë.

3. Shoqëritë ajrore të përcaktuara të secilës Palë Kontraktuese do të marrin miratimin e autoriteteve kompetente për këto transferta brenda tridhjetë(30) ditësh nga data e kërkesës për këtë transfertë. Procedura për këto transferta do të jetë në përputhje me rregullat në fuqi për këmbimin e monedhës së vendit në të cilin sigurohen të ardhurat.

4. Shoqëritë ajrore të secilës Palë Kontraktuese do të jenë të lira të kryejnë transfertat menjëherë pas marrjes së këtij miratimi. Në rast se për arsye teknike, kjo transfertë nuk mund të kryhet menjëherë, shoqërive ajrore të secilës Palë Kontraktuese do t'u garantohen transferta prioritare të ngjashme me ato që u ofrohen importeve të Palës tjetër Kontraktuese.

5. Secila Palë Kontraktuese do t'i garantojë shoqërive ajrore të Palës tjetër Kontraktuese përjashtimin nga të gjitha taksat dhe tarifat mbi fitimin. Të ardhurat do të tatohen vetëm në territorin e Palës Kontraktuese ku gjendet selia kryesore e biznesit të shoqërisë ajrore të përcaktuar në fjalë. Kur ekziston një marrëveshje e veçantë ndërmjet Palëve Kontraktuese për shmangien e tatimit të dyfishtë në lidhje me taksat mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, parashikimet e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

Neni 12

Kapaciteti

1. Shoqëritë ajrore të përcaktuara të çdo Pale Kontraktuese do të kenë mundësi të barabarta dhe të drejta për të operuar shërbimet ajrore të miratuara në rrugët e përcaktuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

2. Gjatë kryerjes së shërbimeve të miratuara, shoqëria(të) ajrore të përcaktuara të çdo Pale Kontraktuese, do të marrin parasysh edhe interesat e shoqërisë(ve) ajrore të përcaktuara nga Pala tjetër Kontraktuese, në mënyrë që të mos ndikojnë padrejtësisht (papërshtatshmërisht) shërbimet të cilat kjo

e fundit kryen tërësisht apo pjesërisht në të njëjtën rrugë ose në rrugë të tjera të rrjetit të vet.

3. Kapaciteti për t'u siguruar nga shoqëritë ajrore të përcaktuara në shërbimet e rëna dakord do të jetë në përputhje të ngushtë me kërkesat e përafërta të publikut që udhëton përmes ajrit ndërmjet territoreve të të dyja palëve Kontraktuese.

4. Frekuenca dhe orari i operimit për shërbimet e rëna dakord do t'i paraqitet autoriteteve aeronautike respektive për miratim përpara operimit të këtyre shërbimeve për të cilat është rënë dakord të paktën tridhjetë ditë përpara hyrjes së tyre në fuqi.

5. Çdo marrëveshje tregtare e lidhur ndërmjet shoqërive ajrore të përcaktuara do t'i paraqitet autoriteteve aeronautike respektive për miratim.

Neni 13

Ndalimi i duhanit në fluturimet ajrore

1. Secila Palë Kontraktuese do t'i ndalojë ose do t'i detyrojë shoqëritë e veta ajrore të ndalojnë pirjen e duhanit në të gjithë fluturimet e pasagjerëve që operohen nga shoqëritë e veta ajrore ndërmjet territoreve të të dyja Palëve Kontraktuese.

2. Ky ndalim do të zbatohet për të gjitha zonat brenda avionit dhe do të jetë në fuqi nga momenti kur fillon embarkimi i pasagjerëve në avion deri në momentin kur përfundon disbarkimi.

3. Secila Palë Kontraktuese do të marrë të gjitha masat që ajo konsideron të arsyeshme për të siguruar përmbushjen e detyrimit të ndalimit të pirjes së duhanit nga shoqëritë e veta ajrore, si dhe nga pasagjerët në avionët e shoqërive të veta ajrore, të përcaktuar në këtë nen, duke përfshirë edhe vënien e sanksioneve të përshtatshme për mosbindjen ndaj këtij detyrimi.

Neni 14

Krijimi i lehtësirave dhe përcaktimi i detyrimeve për përdoruesit

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të vendosë ose të lejojë vendosjen e tarifave të arsyeshme për përdorimin e aeroporteve duke përfshirë instalimet teknike dhe pajisjet e lundrimit ajror, me kusht që këto tarifa të mos jenë më të larta se ato që paguhen nga avionët e shoqërive të tjera ajrore të përfshira në shërbime të ngjashme ajrore ndërkombëtare.

2. Çdo Palë Kontraktuese do të inkurajojë konsultimet ndërmjet organizatave të tyre përgjegjëse të ngarkuara me tarifimin dhe shoqërisë ajrore të përcaktuara që përdorin shërbimet dhe pajisjet në fjalë dhe sa më shumë të jetë e mundur konsultimet nëpërmjet organizatave përfaqësuesve të shoqërive ajrore. Një njoftim i arsyeshëm do t'i jepet përdoruesve për çdo ndryshim të propozuar në tarifat e përdorura për t'u mundësuar atyre shprehjen e pikëpamjeve të tyre para kryerjes së këtyre ndryshimeve të propozuara.

3. Asnjë Palë Kontraktuese nuk do t'i japë përparësi avionëve të shoqërive të veta apo të shoqërive të tjera ajrore të përfshira në shërbime të ngjashme ndërkombëtare ajrore në krahasim me avionët e Palës tjetër Kontraktuese për sa i përket zbatimit të rregulloreve përkatëse të konsumatorëve, imigracionit, karantinës apo shërbimeve të tjera ose në përdorimin e aeroporteve, rrugëve ajrore, shërbimeve të trafikut ajror dhe lehtësirave të lidhura me të që janë nën kontrollin e saj.

Neni 15

Shkëmbimi i informacionit dhe statistikat

Autoritetet aeronautike të secilës Palë Kontraktuese do t'u dërgojnë autoriteteve aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese pasqyra periodike statistikore ose informacion të ngjashëm me të, sipas kërkesës së tyre, me qëllim përcaktimin e kapacitetit që duhet të sigurohet prej shoqërisë(ve) ajrore të përcaktuara, si dhe të llogaritjes së ngarkesës së trafikut të realizuar për shërbimet e miratuara.

Neni 16

Tranziti i drejtpërdrejtë

1. Pasagjerët në tranzit të drejtpëdrejtë përmes territorit të shtetit të njërës prej Palëve Kontraktuese që nuk largohen nga zona e aeroportit e rezervuar për këtë qëllim, do t'i nënshtrohen një

kontrolli të thjeshtuar. Bagazhet dhe ngarkesa në tranzit të drejtpëdrejtë do të përjashtohen nga taksat doganore dhe detyrimet e tjera.

Neni 17
Konsultimi

1. Në frymën e bashkëpunimit të ngushtë, autoritetet aeronautike të secilës Palë Kontraktuese munden që të kërkojnë konsultime me Palën tjetër Kontraktuese në çdo kohë për çdo problem që lidhet me interpretimin dhe zbatimin e kënaqshëm të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të shtojcave të saj.

2. Konsultime të tilla do të fillojnë brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës në rast se nuk është vendosur ndryshe nga vetë Palët Kontraktuese.

Neni 18
Ndryshimet

1. Në qoftë se secila prej Palëve Kontraktuese e konsideron të përshtatshme të ndryshojë ndonjë nga parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, ajo mund të kërkojë në çdo kohë konsultime me Palën tjetër Kontraktuese. Të tilla konsultime ndërmjet autoriteteve aeronautike të Palëve Kontraktuese do të nisin brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e marrjes së kërkesës, po të mos vendoset ndryshe nga Palët Kontraktuese. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje për të cilin është rënë dakord do të hyjë në fuqi sipas procedurave të përcaktuara në nenin 24 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo ndryshim i shtojcës së kësaj Marrëveshjeje do të realizohet nëpërmjet një Marrëveshjeje të drejpërdrejtë ndërmjet autoriteteve aeronautike të Palëve Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi në datën e dorëzimit të njoftimit të fundit diplomatik me shkrim për përfundimin e formaliteteve të brendshme ligjore të nevojshme.

3. Marrëveshja do të ndryshohet në mënyrë që të jetë në përputhje me konventa shumëpalëshe në të cilat mund të aderojnë më pas të dyja Palët Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet negocimeve direkte midis autoriteteve aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese. Nëse autoritetet e përmendura të të dyja Palëve dështojnë të bien dakord nëpërmjet negocimeve, ata mund të bien bashkërisht dakord që t'ia kalojnë mosmarrëveshjen për zgjidhje një personi, një organizate ose organizmi.

2. Nëse Palët Kontraktuese dështojnë të arrijnë një zgjidhje përmes bisedimeve, mosmarrëveshja me kërkesën e një Pale Kontraktuese, do t'i dërgohet për arbitrim një Gjykate Arbitrazhi të përbërë nga tre arbitra, nga një të caktuar nga secila Palë Kontraktuese dhe i treti i caktuar bashkërisht nga të dyja Palët Kontraktuese. Çdo Palë Kontraktuese do të emërojë një arbitër brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga marrja e kërkesës për t'ia kaluar arbitrimit zgjidhjen e mosmarrëveshjes të dërguar përmes kanaleve diplomatike nga Pala tjetër Kontraktuese. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pasi janë emëruar ata, në marrëveshje mes tyre, të dyja Palët Kontraktuese do të caktojnë një arbitër të tretë. Nëse, brenda periudhës së përcaktuar në këtë paragraf, njëra Palë Kontraktuese nuk arrin të emërojë një arbitër ose arbitri i tretë nuk është përcaktuar, secila Palë Kontraktuese ose të dyja bashkë mund t'i kërkojnë Presidentit të Këshillit të Organizatës të Aviacionit Civil Ndërkombëtar të caktojë arbitrin ose arbitrat e nevojshëm brenda tridhjetë (30) ditëve. Në çdo rast arbitri i tretë nuk do të jetë i një kombësie të njëjtë me asnjërën nga Palët Kontraktuese. Ai do të shërbejë si presidenti i Gjykatës së Arbitrazhit dhe do të përcaktojë vendin ku do të bëhet arbitrimi. Përsa kohë nuk është i pranuar ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë vetë rregullat procedurale dhe nëse është e nevojshme, do të përcaktojë juridiksionin dhe ligjin e zbatueshëm në përputhje me këtë Marrëveshje.

3. Në çdo rast Gjykata e Arbitrazhit do të japë vendime përfundimtare me shkrim përfshi arsyetimin përkatës, i cili është i detyrueshëm për të dyja Palët Kontraktuese, përsa kohë nuk është pranuar ndryshe nga të dyja Palët Kontraktuese kur vendosen t'ia përcjellin mosmarrëveshjen për zgjidhje kësaj Gjykate Arbitrazhi.

4. Shpenzimet e arbitrave të secilës Palë Kontraktuese do të përballohen nga Pala respektive Kontraktuese. Të gjitha shpenzimet e tjera të Gjykatës së Arbitrazhit, përfshi pagesat dhe shpenzimet e arbitrit të tretë, do të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet të dyja Palëve Kontraktuese.

5. Nëse dhe deri në kohën që njëra Palë Kontraktuese nuk i bindet vendimit përfundimtar dhe të detyrueshëm të dhënë në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, Pala tjetër Kontraktuese, mundet të tërheqë ose revokojë çdo të drejtë ose privilegj që i ka dhënë kësaj Pale Kontraktuese ose shoqërisë ajrore të përcaktuar të kësaj Pale Kontraktuese kushdo që të jetë ajo që nuk i është bindur vendimit të arbitrazhit.

Neni 20
Rregjistrimi

Kjo Marrëveshje, çdo ndryshim që do t'i bëhet asaj, si dhe shkëmbimi i notave diplomatike në lidhje me të do të regjistrohet në Organizatën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

Neni 21
Mbarimi

1. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

2. Secila Palë Kontraktuese mund t'i komunikojë me shkrim Palës tjetër Kontrktuese në çdo kohë, vendimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje. Një njoftim i tillë do t'i komunikohet njëkohësisht edhe Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar. Në këtë rast kjo Marrëveshje do të përfundojë dymbëdhjetë (12) muaj pas datës së dorëzimit të njoftimit Palës tjetër Kontraktuese, me përjashtim të rastit kur njoftimi për këtë përfundim është tërhequr përpara datës së përfundimit të kësaj periudhe.

3. Në mungesë të një konfirmimi për marrjen e njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, njoftimi do të gjykohet se është marrë katërmbëdhjetë (14) ditë pas marrjes së njoftimit nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e dorëzimit të njoftimit të fundit diplomatik me shkrim për përfundimin e formaliteteve të brendshme ligjore të nevojshme të shkëmbyer ndërmjet Palëve Kontraktuese për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht prej Palëve Kontraktuese, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 11 maj 2006 në dy kopje origjinale secila në gjuhët shqipe, izraelite dhe angleze, të gjitha tekstet autentikisht të njëjta. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM
Nr.60, datë 27.9.2006

PËR MOSMIRATIMIN E OBJEKTIT TË KËRKESËS SË 35 DEPUTETËVE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR "PËR VERIFIKIMIN E LIDHJEVE NEPOTIKE, KONFLIKTIN E INTERESIT DHE PËRFITIMEVE PASURORE QË RRJEDHIN PREJ TYRE PËR KRYEMINISTRIN SALI BERISHA, FAMILJARËT DHE

TË AFËRMIT E TIJ”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe në bazë të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës së 35 deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për objektin “Për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin Sali Berisha, familjarët dhe të afërmit e tij” për shkak se objekti i kërkesës së mësipërme është i njëjtë, tërësisht i ezauruar, me objektin e vendimit të Kuvendit nr.59, datë 18.9.2006 “Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.61, datë 27.9.2006

PËR EMËRIMIN E BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 34 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Elisabeta Gjoni (Semini) emërohet Kryetare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes financiare për 5 vjet.

II. Zoti Keler Gjika emërohet Nënkryetar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe disiplinimit për 5 vjet.

III. Zonja Ermela Guxholli emërohet Nënkryetare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe drejtuese e Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit për 4 vjet.

IV. Zonja Miranda Ramaj emërohet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për 5 vjet.

V. Zonja Diana Lamani emërohet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për 4 vjet.

VI. Zonja Silvana Bello emërohet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për 3 vjet.

VII. Zonja Rajmonda Shaqiri emërohet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes financiare për 3 vjet.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

UDHËZIM
Nr.5, datë 4.10.2006

PËR RREGULLAT QË DUHEN RESPEKTUAR PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NË FUSHATË ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 3 pika 7, nenit 5, nenit 29 pika 1, nenit 134 pika 1 dhe nenit 135 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Parime të përgjithshme
Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që duhen zbatuar për afishimin e materialeve propagandistike gjatë periudhës zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore.

Neni 2

1. Organet e Qeverisjes Vendore janë të detyruara të caktojnë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore.
2. Caktimi i vendeve për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore bëhet publik dhe u njoftohet partive politike jo më vonë se 10 ditë nga dalja e Dekretit të Presidentit, për caktimin e datës së zgjedhjeve,

Neni 3

Për qëllim të këtij udhëzimi partitë pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, ndahen në parti parlamentare dhe parti joparlamentare.

Neni 4
Caktimi i vendeve të afishimit

1. Caktimi i vendeve publike për afishim realizohet duke përcaktuar vende, sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabarta për secilën parti, brenda grupit ku bën pjesë.
2. Për partitë parlamentare vendi dhe sipërfaqja, për afishimin e materialeve propagandistike, është sa dyfishi i vendit dhe sipërfaqes që u caktohet partive joparlamentare.
3. Në caktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike Organet e Qeverisjes Vendore duhet të mbajnë parasysh:
- sheshet publike dhe afërsinë e tyre me qendrën e njësisë administrative përkatëse;
- rrugët kryesore;
- vendet e veçanta të caktuara për afishim;
- mundësinë e ndriçimit.
4. Ndalohet vendosja dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore në ndërtesat e institucioneve publike.

Neni 5
Respektimi i barazisë

Vënia në dispozicion e sipërfaqeve për afishimin e materialeve propagandistike, bëhet me të njëjtin çmim për sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabartë.

Neni 6
Personat juridikë dhe fizikë

Personat juridikë apo fizikë që ushtrojnë aktivitet në fushën e reklamave në territorin e njësisë vendore përkatëse, janë të detyruar që të respektojnë parimet e barazisë ndërmjet subjekteve zgjedhore, në rastin kur afishojnë materiale propogandistike zgjedhore.

Neni 7
Kompensimi

1. Në rastet kur KZQV konstaton shkelje të dispozitave të këtij udhëzimi, me vendim urdhëron kompensimet përkatëse të cilat realizohen menjëherë.
2. Vendimi i KZQV i dërgohet menjëherë Organit të Qeversisjes Vendore përkatëse.

Neni 8
Sanksionet

Në rastet e kundërvajtjeve administrative, KQZ vendos sanksionet administrative të parashikuara në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çlirim Gjata	Kryetar
Flamur Çato	Zv/Kryetari
Dëshira Subashi	Anetar
Klement Zguri	Anëtar
Arben Ristani	Anëtar
Fatmir Kumbaro	Anëtar

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…….....**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….....**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....**	**1500**
4.	**PËR TAKSAT DHE TATIMET…(+ suplement 2006)…….....**	**1500**
5.	**PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…….....**	**500**

Botime të reja

1	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I)…....….....**	**1000**
2	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006(Vëllimi II)…....….....**	**500**
3	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I)……..….....**	**1000**
4	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)……..….....**	**500**
5	**PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…….....**	**1000**
6	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR…….**	**800**
7	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDERTIMET……....….....**	**500**
8	**PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)…….....**	**1000**
9	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE…….....**	**500**

Hyri në shtyp më 12.10.2006
Doli nga shtypi më 16.10.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë